

Regjistrimi i popullsisë nga këndvështrimi i komuniteti serb në Kosovë

Qershor
2022



PËRMBAJTJA

Rreth Nismës Open 7

01.

**METODOLOGJIA
DHE STRUKTURA E
MOSTRËS** 8

02.

HYRJE 11

Rreth hulumtimit 11

Rreth partnerëve të
projektit 11

03.

PËRMBLEDHJE 12

Konteksti 12

Metodologjia e hulumtimit 12

Gjetjet kyçe 13

Rekomandimet kyçe 13

04.

**REGJISTRIMI NGA
KËNDVËSHTRIMI I
KOMUNITETI
SERB NË KOSOVËS** 14

Koncepti i regjistrimit të
popullsisë dhe ekonomive
familjare 14

Regjistrimet e popullsisë
në Kosovë 17

Regjistrimet e popullsisë
para vitit 2011 18

Regjistrimi i Popullsisë dhe
ekonomive familjare në
vitin 2011 26

Projektligji për regjistrimin
e popullsisë dhe
perspektivat për mbajtjen
e regjistrimit në Kosovë 30

05.

**QËNDRIMET
E SERBËVE TË
KOSOVËS LIDHUR
ME REGJISTRIMIN
E ARDHSHËM TË
POPULLSISË** 34

Qëllimi dhe metodologjia
e hulumtimit 34

Gjetjet sasiore të
hulumtimit 35

Gjetjet cilësore të
hulumtimit 41

Regjistrimi i bojkotuar i vitit
2011 41

Pjesëmarrja e personave
të zhvendosur 42

Roli i komunitetit
ndërkombëtar 43

Pritjet nga regjistrimi i
popullsisë 43

Vlerësimet e numrit të
përgjithshëm aktual të
serbëve në Kosovë 45

Faktorë tjerë që
përcaktojnë vendimin për
pjesëmarrje në regjistrim 45

06.

REKOMANDIME 47

Titulli i hulumtimit: Regjistrimi i popullsisë nga këndvështrimi i komuniteti serb në Kosovë

Botues: Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS

Për botuesin: OJQ AKTIV dhe Qendra për të Drejtat e Komuniteteve të Pakicave (QDKP)

Autorë: Igor Markoviq

Lekturimi: Igor Markoviq

Ky dokument fillimisht është shkruar në gjuhën serbe

Përkthimi në gjuhën shqipe: Xhenana Azizi

Dizajn: tedel

Shtypshkronja (Tirazhi): 80

Ky botim u realizua në kuadër të projektit OPEN të implementuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) në bashkëpunim me organizatat OJQ AKTIV Qendra për të Drejtat e Komuniteteve të Pakicave (QDKP). Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e KFOS.

Viti i publikimit: Qershor 2022

Rreth Nismës Open

Demokracia, haptësia dhe perspektivat e komunitetit serb në Kosovë – OPEN është nismë e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), që ka filluar gjatë vitit 2020. Kjo nismë ka për qëllim të zhvillojë hapësirë të hapur e dinamike për diskutime brenda dhe mes komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera si dhe me institucionet e Kosovës.

Organizatave e shoqërisë civile nga komuniteti serb në Kosovë, anëtare të nismës, merren specifikisht me analiza dhe vlerësime të ndikimit të organizatave civile e politike në zhvillimin e demokracisë, si dhe në haptësinë e komunitetit serb në Kosovë. Me këto analiza vlerësohet haptësia e institucioneve, politikave publike dhe proceseve të rëndësishme karshi komunitetit serb në Kosovë, si dhe niveli i haptësisë së komunitetit serb karshi tyre.

Këto analiza do të ndihmojnë të pasqyrohet gjendja aktuale dhe perspektivat e komunitetit serb në Kosovë, duke shërbyer njëkohësisht edhe si bazë për përfaqësimin e argumentuar të orientuar drejt vendimmarrësve, institucioneve të pushtetit lokal e qendror, si dhe bashkësisë ndërkombëtare.

1. Metodologjia dhe struktura e mostrës

Anketimi ballë për ballë në terren u krye në periudhën tetor-nëntor 2021. Gjithsej 500 qytetarë serb u anketuan në të gjithë Kosovën. Pyetësi përbëhej nga 46 pyetje dhe përf-

shinte gjithsej 6 fusha. Mostra ishte e qëllimshme, me kuotë, dhe kriteri për përcaktimin e kuotave ishte madhësia e komunës. Intervali i besimit është +/- 5.

Anketimi ballë për ballë në terren u krye në periudhën tetor-nëntor 2021. Gjithsej

500

qytetarë serb u anketuan në të gjithë Kosovën



Arsimimi i të anketuarve

5.4% me arsim fillor

47% me arsim të mesme

45% me arsim të lartë, pra fakultet.

Punësimi i të anketuarve

25.9% janë të punësuar

42% nuk punojnë ose janë në pension

Në mostër ishin gjithsej

60.2%



39.8%














Mosha mesatare e respondentëve ishte
42 vjeç.

Intervali i besimit përmban +/-5.

* Është e rëndësishme të theksohet se duke pasur parasysh faktin se nuk ka statistika zyrtare mbi strukturën demografike të popullsisë së synuar, pra të popullsisë serbe në Kosovë, vetëm kushtimisht mund të flitet për përfaqësim të mostrës.

Shpërndarja sipas vendbanimit është bërë si në vijim:

KOMUNA:	FREKUENCA:	PËRQINDJA:	PËRQINDJA E VLEFSHME:	PËRQINDJA KUMULATIVE:
Leposaviq	110	22.0	22.0	22.0
				
Kamenicë	10	2.0	2.0	24.0
				
Novobërdë	30	6.0	6.0	30.0
				
Zubin Potok	50	10.0	10.0	40.0
				
Shtërpcë	30	6.0	6.0	46.0
				
Zveçan	60	12.0	12.0	58.0
E vlefshme:				
Graçanicë	60	12.0	12.0	70.0
				
Ranillug	30	6.0	6.0	76.0
				
Partesh	10	2.0	2.0	78.0
				
Kllokot	10	2.0	2.0	80.0
				
Mitrovica e Veriut	100	20.0	20.0	100.0
				
Total:	500	100.0	100.0	

Metodologjia dhe dizajni i kërkimit cilësor

GRUPET E FOKUSIT

Periudha:

Hulumtimi është kryer në periudhën mars 2022 - prill 2022.

Instrumenti i hulumtimit:

Një udhëzues për realizim të bisedës me (16) pyetje

Numri i grupeve të fokusit:

8 grupe të fokusit

Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve:

24 pjesëmarrës (nga 8 pjesëmarrës në secilin fokus grup)

Kriteret për përzgjedhjen e pjesëmarrësve:

gjinia, mosha, profesioni, vendbanimi, niveli i arsimimit, punësimi

INTERVISTAT

Periudha:

Hulumtimi u realizua në periudhën nga 9.1.2022 deri më 19.4.2022.

Instrumenti i hulumtimit:

Udhëzues për realizim të intervistës me (11) pyetje

Numri i përgjithshëm i të intervistuarve:

12 të intervistuar

Kriteri për zgjedhjen e bashkëbiseduesve:

ekspertiza, angazhim dhe njohuri në fushat që lidhen drejtpërdrejt me procesin e regjistrimit të popullsisë

Bashkëbiseduesit:

ekspertët e intervistuar janë (insistuan të mbeten) anonimë

2. Hyrje

Rreth hulumtimit

Në analizën *Regjistrimi i popullsisë nga këndvështrimi i komunitetit serb në Kosovë* shtjellohen faktorët që do të ndikojnë në vendimin e serbëve të Kosovës për (mos) pjesëmarrje në regjistrimin e ardhshëm të popullsisë. Qëllimi i hulumtimit është të shqyrtojë rolin e Beogradit dhe Prishtinës në mobilizimin e popullatës për të marrë pjesë në regjistrim, bojkotimet e mundshme të procesit, si dhe pritjet dhe frikën nga regjistrimi dhe rezultatet. Ky hulumtim është realizuar në partneritet me OJQ AKTIV dhe QDKP.

Rreth partnerëve të projektit

OJQ AKTIV është një organizatë joqeveritare që kërkon të inkurajojë pjesëmarrjen qytetare përmes komunitetit në fushat e zhvillimit ekonomik, kulturor dhe shoqëror. Prandaj, projektet dhe puna në rajon pasqyrojnë një qasje holistike në zgjidhjen e problemeve dhe një besim të fuqishëm në gjithëpërfshirjen e komunitetit dhe pjesëmarrjen aktive në jetën qytetare. Duke reflektuar qasjen e saj shumëpalëshe, projektet e OJQ AKTIV kanë qenë jashtëzakonisht të larmishme dhe të zgjeruara duke përfshirë projekte të përqendruara në fuqizimin e kapacitetit të institucioneve publike lokale, rritjen e qasjes së grupeve të cënueshme brenda Kosovës në mekanizmat gjyqësorë si dhe çështjet e sundimit të ligjit. Me rritjen e pjesëmarrjes së AKTIV-it në komunitetin lokal, si dhe thellimit të bashkëpun-

imit me organizata të tjera të shoqërisë civile, organizata ndërkombëtare dhe sektorin publik në nivelin lokal dhe qendror, AKTIV arriti që me projektet e tij të zgjerojë shtrirjen dhe mbulimin. Kështu, AKTIV kërkon të mundësojë pjesëmarrje kuptimplote të komunitetit serb të Kosovës në nxitjen e një të ardhme paqësore dhe të prosperuar në rajon, ku individë dhe institucione të fuqizuara të komuniteteve të hapura dhe aktive kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës përmes procedurave të hapura, transparente dhe demokratike, duke respektuar të drejtat e njeriut.

Qendra për të Drejtat e Komuniteteve Pakicë (QDKP) (ang. *Center for Rights of Minority Communities*) është organizatë joqeveritare me seli në Osojan (komuna e Istogut) e cila merret me promovimin e të drejtave dhe pozitës së përgjithshme të komuniteteve joshumicë në Kosovë përmes fushatave të ndërgjegjësimit dhe punës së drejtpërdrejt me aktivistët lokalë. QDKP përqendron punën e saj në fushat që përndryshe janë neglizhuar nga palët politike dhe ndërkombëtare të interesit, siç janë komunitetet e të kthyerve në Kosovën perëndimore.

3. Përmbledhje

Konteksti

Në Kosovë në tre dekadat e fundit nuk është bërë asnjë regjistrim i plotë dhe gjithëpërfshirës i popullsisë. Regjistrimi i fundit i popullsisë, i cili u mbajt në përputhje me standardet minimale të përcaktuara nga organizatat ndërkombëtare dhe me pjesëmarrje (relativisht) të plotë të qytetarëve, u mbajt, tashmë në vitin e largët 1981, në kohën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Regjistrimi tjetër i mbajtur në vitin 1991 u bojkotua nga shumica e shqiptarëve, si dhe nga një pjesë e boshnjakëve dhe romëve, kështu që të dhënat e mbledhura nuk pasqyronin një pasqyrë objektive të numrit të popullsisë së Kosovës. Për shkak të luftës në fund të viteve të nëntëdhjeta, si dhe përpjekjeve për të ndërtuar paqen nën patronazhin e komunitetit ndërkombëtar, kushtet themelore të sigurisë, administrative dhe procedurale për realizimin e regjistrimit të popullsisë në vitin 2001 në Kosovë nuk ekzistonin.

Pas shpalljes së pavarësisë, ishte e nevojshme që regjistrimi të bëhej në vitin 2011. Në një atmosferë të nxitur politike dhe lajme të freskëta për marrëveshjet e nënshkuara të Brukselit, ky cikël i regjistrimit të popullsisë dhe ekonomive familjare përjetoi një debakël. Në katër komuna në veri të Kosovës (Mitrovicën e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan), regjistrimi i popullsisë nuk është bërë, ndërkohë që shumica e pjesëtarëve të komunitetit serb që jetojnë në jug të lumit Ibër e bojkotuan dukshëm procesin.

Në vitin 2016, Kuvendi i Kosovës ka paraqitur një iniciativë për miratimin e të ashtuquajturit Ligjit për zbatimin e regjistrimit të popullsisë në veri i cili do të kompensonte mungesën e të dhënave. Megjithatë, kjo nismë nuk dha fryt. Regjistrimi gjatë muajit prill 2021 nuk u krye për shkak të pandemisë, dhe u shty për në vitin 2022. Ndërkaq, tema e regjistrimit të popullsisë në Kosovë ishte larg nga kryesimi i agjendës politike, dhe përfaqësuesit politikë të serbëve në Kosovë, por edhe Beogradi zyrtar, asnjëherë nuk u deklaruar rreth pjesëmarrjes së këtij komuniteti në regjistrimin e popullsisë në Kosovë. Serbët e Kosovës nuk janë informuar për regjistrimin e popullsisë, i cili në ndërkohë u paralajmërua për në fund të vitit 2022, gjë që paraprakisht krijon predispozita për të përsëritur skenarin e njëjtë apo të ngjashëm - **dështimin e regjistrimit të popullsisë në Kosovë**. Në rrethana të tilla, ishte e nevojshme të bëhet një studim i thellë i qëndrimeve, interesave, frikës dhe dëshirave të pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës për pasojat dhe implikimet që mund të ketë (mos) pjesëmarrja dhe rezultatet e regjistrimit.

Metodologjia e hulumtimit

Partnerët e hulumtimit organizuan gjithsej tetë fokus grupe, pesë në komunat në jug të lumit Ibër, ndërsa tre të tjerat u mbajtën në komunat e Mitrovicës së Veriut, Zveçanit dhe Zubin Potokut. Për të kompletuar, individualizuar dhe sqaruar të dhënat e mbledhura, partnerët zhvilluan dym-

bëdhjetë intervista ekspertësh me akterë kyç nga komuniteti serb i Kosovës, me njohuri relevante për historinë, rëndësinë dhe procedurat e procesit të regjistrimit të popullsisë dhe ekonomive familjare në Kosovë dhe zonat që kanë rëndësi ose ndikim të menjëhershëm në temën e këtij studimi.

Krahas aktiviteteve kërkimore të realizuara nga OJQ AKTIV dhe Qendra për të Drejtat e Komuniteteve Pakicë, nisma OPEN me ndihmën e anketave realizoi sondazhin e opinionit publik. Me këtë metodë janë përfshirë 500 të anketuar - pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës - ndërsa u shqyrtuan qëndrimet në fushat me rëndësi dhe interes për këtë komunitet joshumicë. Ndër të tjera, tema e regjistrimit të ardhshëm të popullsisë ishte pjesë e spektrit të kërkimit, ndërsa rezultatet e anketës janë përfshirë dhe prezantuar në këtë publikim. Qasja metodologjike në fjalë synonte të inkurajonte serbët e Kosovës që të flisnin hapur dhe lirshëm për pasojat që do të gjeneronte procesi i regjistrimit në mesin e pjesëtarëve të tyre, me hapësirë të hapur për të sugjeruar mënyrën e realizimit të të njëjtit.

Gjetjet kyçe

Aktivitetet kërkimore treguan se pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës kanë pikëpamje të ndryshme, por uniforme dhe konsistente rreth ndikimit të mundshëm të procesit të regjistrimit në jetën e tyre të përditshme në Kosovë. Gjetjet kryesore të nxjerra nga hulumtimi treguan për një këndvështrim të këtij komuniteti rreth:

- çështjes për pjesëmarrje në regjistrim nën ndikimin e një numri faktorësh të ndryshëm (kyç është gjendja e sigurisë, ruajtja e të drejtave të garantuara dhe nevoja për të përcaktuar numrin e përgjithshëm të serbëve që jetojnë në Kosovë), dhe mungesës së konsensusit në nivel komuniteti rreth kësaj teme;
- pothuajse gjysma e të anketuarve (47,6%) theksuan se do të merrnin pjesë në regjistrim;

- deri më tani asnjë institucion apo akter politik përkatës nuk i ka informuar qytetarët serbë për kohën dhe mënyrën e mbajtjes, procedurat dhe organet kompetente lidhur me regjistrimin, edhe pse shumica e qytetarëve janë të vetëdijshëm për thelbin dhe objektivat e procesit;
- është me rëndësi të jashtëzakonshme që personave të zhvendosur t'u mundësohet pjesëmarrja në regjistrim, si dhe që pronat e tyre të uzurpuara ose jo të uzurpuara të regjistrohen në mënyrë adekuate;
- gjatë gjithë procesit të regjistrimit, pjesëtarët e tij do të përfshihen aktivisht në organet përkatëse.

Rekomandimet kyçe

- Realizimi i një fushate informuese publike për regjistrimin e popullsisë në gjuhën serbe që do të ofrojë informacion të detajuar dhe të kuptueshëm rreth detajeve të këtij procesi.
- Një përcaktim më i qartë dhe preciz i shtrirjes së popullsisë që definohet si rezident, dhe t'u mundësohet pjesëmarrja personave të zhvendosur dhe inventarizimi i paanshëm i pasurisë së tyre private ose të uzurpuar.
- Përkthimi adekuat i materialit shoqërues të regjistrimit dhe përshtatja e regjistrimit të digjitalizuar për personat në nevojë.
- Të mundësohet që përfaqësuesit e serbëve të Kosovës dhe organizatave joqeveritare nga radhët e këtij komuniteti të marrin pjesë aktive dhe të zgjidhen anëtarë të Komisionit Qendror dhe Komunal të Regjistrimit, si organe kyçe për monitorimin e rregullsisë së regjistrimit të popullsisë.
- Sigurimi i mekanizmave minimalë monitorues nga komuniteti ndërkombëtar, i cili nga ana tjetër do të kontribuojë në mbledhjen e të dhënave që nuk do të jenë objekt dyshimi.

4. Regjistrimi nga këndvështrimi i komuniteti serb në Kosovës

Koncepti i regjistrimit të popullsisë dhe ekonomive familjare

Sipas burimeve historike të disponueshme, regjistrimi më i vjetër i regjistruar u organizua në Perandorinë Babilonase rreth vitit 3800 para Krishtit, kur u mbledhën të dhëna për numrin e bagëtive, sasinë e gjalpit, qumështit, mjaltit, leshit dhe perimeve. Për regjistrimi e popullsisë është pritur për pesë shekuj dhe sipas të dhënave të ruajtura në shekullin II para Krishtit, dinastia kineze Han bëri regjistrimin e parë jo të plotë të qytetarëve dhe përcaktoi se territori nën sundimin e saj është i banuar nga 57.7 milion njerëz në 12.4 milion ekonomi familjare.¹ Shekujt në vijim dëshmuar zhvillimin e sistemit të regjistrimit të banorëve dhe ekonomive familjare me qëllim të sistemit të të dhënave, të cilat do t'i shërbenin më tej zhvillimit të planifikuar të njësive të caktuara territoriale. Për këtë arsye gjatë periudhës koloniale u vëzhgua popullsia e territoreve të sapo pushtuara, për të filluar shfrytëzimin e planifikuar të burimeve njerëzore dhe natyrore. Ndërsa në shekullin e katëmbëdhjetë në Ande gjendja numerike e Perandorisë së Inkëve u ruajt dhe u plotësua me nyje në tela nga

qimet e lamës, e në prerjet e Shteteve të Bashkuara gjatë fundit të shekullit të tetëmbëdhjetë, regjistrimi u krye nga anketuesit në kalë. Sidoqoftë, regjistrimi i parë i plotë, i cili përfshinte të gjithë popullsinë e një zone të caktuar sipas sistemit nominal, u mbajt në Islandë në vitin 1703.²

Edhe pse rast i izoluar i asaj periudhe, rasti islandez në një periudhë të historisë do të pasohet nga një pikë referimi për mënyrën, metodat dhe qëllimin e mbajtjes së regjistrimit në mbarë botën. Kërcimi i papritur i trendit të kryerjes së regjistrimit të përgjithshëm ndodhi gjatë çerekut të parë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, për shkak të rritjes së kërkesës për të dhëna të sakta statistikore, të cilat ishin shumë të rëndësishme për periudhën e industrializimit të shpejtë, veçanërisht në kontinentin evropian. Perandoria Osmane pas zhvillimit të postulateve bazë të regjistrimit, përsosi metodat e mbledhjes së të dhënave dhe zgjeroi shtrirjen e regjistrimit të popullsisë nga kontinenti i Evropës në Azi. Sistemi i mbledhjes së taksave është përmirësuar kudo ku është kryer regjistrimi i popullsisë, gjë që ka kontribuar ndjeshëm në forcimin e strukturave administrative dhe burokracisë, planifikimin afatgjatë ekonomik dhe financiar (në nivel të njësive

1 ThoughtCo., The Demographics of Dynastic China, 2019, mund të gjendet në: <https://www.thoughtco.com/demographics-of-ancient-china-117655> (datë: 11 dhjetor 2021)

2 UNESCO, The 1703 Census of Iceland, 2012, mund të gjendet në: <https://en.unesco.org/memoryoftheworld/registry/200> (datë: 11 dhjetor 2021)

territoriale) dhe forcimin e sovranitetit. Kjo, në gjysmën e parë të shekullit të nëntëmbëdhjetë ishte veçanërisht e rëndësishme për rajonet autonome (Moldavinë, Vllahinë, Serbinë - 1834) dhe shtetet e sapoformuara (Greqinë - 1828), të cilat hapën rrugën e tyre të re të zhvillimit të pavarur dhe u ndërtuan mbi të dhëna statistikore të mbledhura në territoret e tyre.

Fakti që procese të ndryshme metodologjike të regjistrimit u zhvilluan dhe u zbatuan në mbarë botën gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe fillimit të shekullit njëzetë, bëri të nevojshme standardizimin e mbledhjes së të dhënave statistikore që nuk do të kufizoheshin më në kufijtë shtetërorë, por u bënë universale. Megjithatë, rruga e unifikimit dhe standardizimit të parimeve metodologjike që do të vlenin dhe respektoheshin në nivel botëror ishte shumë e gjatë. Megjithëse përpjekjet e para serioze për standardizimin e regjistrimit në nivel ndërkombëtar mund të gjenden në punën dhe angazhimin e Lidhjes së Kombeve ndërmjet dy luftërave botërore³, proces ky i cili arriti kulmin në punën e pasuesit të tij - Kombeve të Bashkuara. Rrethanat dhe rendi i ri i paracaktuar nga pasojat shkatërruese të Luftës së Dytë Botërore dhe ideja e nevojës për vendosjen e një minimumi standardesh, rregullash dhe procedurash ndërkombëtare në veprimtari të ndryshme jetësore, në procesin e regjistrimit krijoi një kërkesë për harmonizim. Për këtë qëllim, në vitin 1947 u formua (në kuadër të Departamentit të OKB-së për Çështjet Ekonomike dhe Sociale) *Zyra e Kombeve të Bashkuara për Statistikat* e cila nxjerr standardet dhe metodat e mbledhjes së të dhënave, duke ndihmuar autoritetet kombëtare statistikore dhe subjektet e tjera zyrtare të statistikave në planifikimin dhe kryerjen e regjistrimeve të suksesshme të popullsisë dhe ekonomive familjare. Organi që më vonë ndryshoi emrin në *Divizioni i Statistikave të Kombeve të Bashkuara* ka kontribuar shumë në unifikimin e standardeve ndërkombëtare të procesit të regjistrimit, i cili ndërkohë është bërë një praktikë e mirë përfillur në mbarë botën.

3 Frank W. Notestein, *Demographic Work of the United Nations, Population Index Vol. 16, No. 3, 1950, f. 183*, mund të gjendet në: <https://www.jstor.org/stable/2730608> (datë: 13 dhjetor 2021)

Si pasojë e nevojës për të zhvilluar këto standarde, në vitin 1958 Divizioni i Statistikave të Kombeve të Bashkuara publikoi grupin e parë të rekomandimeve dhe parimeve për ruajtjen e regjistrimit të popullsisë dhe ekonomive familjare, të cilat do të praktikoheshin globalisht. Përkundër faktit se me kalimin e kohës korniza ndërkombëtare e regjistrimit ka evoluar, zgjeruar dhe përmirësuar, udhëzimet e ofruara nga Zyra Statistike e OKB-së gjithmonë kanë përfshirë udhëzime uniforme mbi karakteristikat kryesore të qasjes së regjistrimit, udhëzime të përgjithshme mbi zbatimin dhe metodat e regjistrimit, si dhe udhëzime të hollësishme për përmbajtjen e materialit të regjistrimit të popullsisë. Për më tepër, Departamenti i Statistikave është fokusuar në tre fusha kyçe gjatë viteve të angazhimit:

- 1) koordinimin e programit universal ndërkombëtar të regjistrimit duke nxjerrë (dhe rishikuar) udhëzime dhe rekomandime,
- 2) ofrimin e ndihmës teknike dhe logjistike për shtetet që kryen regjistrimin, dhe
- 3) mbledhjen dhe shpërndarjen e rezultateve të regjistrimit nga shtetet (ose zonat).

Këto tre fusha u bënë pjesë përbërëse dhe përshtuan parimet bazë të statistikave zyrtare që u pranuan në vitin 1994 në nivel të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara. Asambleja e Përgjithshme e kësaj organizate më të rëndësishme ndërkombëtare zyrtarisht në vitin 2014 miratoi *Parimet themelore për statistika zyrtare* si një dokument të vërtetuar në nivelin më të lartë politik, i cili do të mundësojë që informacioni objektiv dhe i besueshëm i mbledhur në terren të jetë një bazë e vlefshme dhe e mirëqenë për procesin e vendimmarrjes, qoftë në nivel lokal, kombëtar apo global. Përveç parimeve të mësipërme që shtrojnë bazën për zbatimin adekuat dhe të pandërprerë të procesit të mbledhjes së të dhënave, ato gjithashtu ofrojnë një pasqyrë mbi rëndësinë thelbësore të këtij procesi, dhe për këto arsye është e rëndësishme që ato të cekën individualisht (siç parashihen në *Parimet bazë*⁴):

4 United Nations Statistics Division, *Fundamental Principles of Official Statistics, 2014*, mund të gjendet në: https://unstats.un.org/unsd/dnss/hb/E-fundamental%20principles_A4-WEB.pdf (datë: 13 dhjetor 2021)

① Rëndësia, paanshmëria dhe qasja e barabartë

Një faktor i pashmangshëm në hapësirat dhe sistemet e informacionit të shoqërive demokratike janë të dhënat zyrtare, pasi ato i shërbejnë qeverisë, publikut dhe ekonomisë për të kuptuar situatën aktuale (dhe krahasuese) ekonomike, sociale, demografike dhe mjedisore. Prandaj, në baza të paanshme, agjencitë zyrtare të statistikave do të përpilojnë dhe vënë në dispozicion statistika zyrtare që plotësojnë kushtet e përdorimit praktik, në mënyrë që të respektohet përfundimisht e drejta e qytetarëve për qasje në informacionin publik.

② Standardet profesionale dhe etika

Agjencitë statistikore, për të ruajtur besimin në statistikat zyrtare, duhet të marrin vendime ekskluzivisht në përputhje me praktikat profesionale, duke përfshirë parimet shkencore dhe etikën profesionale, pra metodat dhe procedurat për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe paraqitjen e të dhënave statistikore.

③ Llogaridhënia dhe transparenca

Për të mundur interpretimin e saktë të të dhënave, agjencitë statistikore duhet të ndajnë informacionin me publikun në përputhje me standardet shkencore rreth burimeve, metodave dhe procedurave statistikore.

④ Parandalimi i keqpërdorimit

Agjencitë statistikore kanë të drejtë, pavarësisht nga institucionet e tjera, të komentojnë ose të sugjerojnë për keqinterpretime ose keqpërdorime të statistikave.

⑤ Burimet e statistikave zyrtare

Të dhënat e mbledhura për qëllime statistikore mund të mblidhen nga të gjitha llojet e burimeve, qofshin ato të dhëna administrative-burokratike apo anketa statistikore. Agjencitë statistikore duhet të zgjedhin burimet e të dhënave bazuar në cilësinë, afatin kohor, koston dhe ngarkesën e mundshme për të anketuarit.

⑥ Konfidencialiteti

Të dhënat individuale të mbledhura nga agjencitë statistikore duhet të jenë rreptësisht konfidenciale dhe të përdoren ekskluzivisht për qëllime statistikore, pa marrë parasysh a bëhet fjalë për persona fizikë apo juridikë.

⑦ Legjislacioni

Ligjet, rregulloret dhe masat mbi bazën e të cilave funksionojnë sistemet statistikore duhet të jenë të qasshme për publikun.

⑧ Koordinimi kombëtar

Për të arritur qëndrueshmëri dhe efikasitet në funksionimin e sistemeve statistikore, qëndrueshmëria e koordinimit ndërmjet agjencive të ndryshme statistikore brenda vendeve është thelbësore.

⑨ Përdorimi i standardeve ndërkombëtare

Përdorimi i standardeve, klasifikimeve dhe metodave ndërkombëtare nga agjencitë statistikore në çdo vend promovon qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e sistemeve statistikore në të gjitha nivelet zyrtare.

⑩ Bashkëpunimi ndërkombëtar

Bashkëpunimi dypalësh dhe shumëpalësh në mbledhjen e statistikave kontribuon në përmirësimin e sistemit të statistikave zyrtare në të gjitha vendet.

Bazuar në parimet e mësipërme, secili prej vendeve kryen një regjistrim të banorëve dhe ekonomive familjare në përputhje me rrethanat lokale, qofshin ato që kanë të bëjnë me legjislacionin e brendshëm ose predispozitat gjeografike, socio-ekonomike dhe kulturore. Përdorimi i udhëzuesve praktik, si ai më i rëndësishmi i lëshuar nga Kombet e Bashkuara - *Parimet dhe rekomandimet për regjistrimin e popullsisë dhe ekonomive familjare*⁵, agjencitë statistikore në mbarë botën kryejnë aktivitete komplekse në intervale të caktuara që kërkojnë planifikim të detajuar dhe të kujdesshëm, sigurimin e burimeve dhe përpjekjeve të ndryshme - nga hartëzimi i të gjithë vendit, mobilizimi dhe trajnimi i një numri të madh regjistruesh dhe fushatat për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, deri te anketimi i të gjitha ekonomive familjare, monitorimi i kujdesshëm i aktiviteteve të regjistrimit dhe analiza, shpërndarja dhe përdorimi i të dhënave të mbledhura. Pra, rishikimi i fundit i dokumentit *Parimet dhe rekomandimet* nga viti 2017 në mënyrë koncize dhe të qartë e përkufizon procesin e regjistrimit si “proces të përgjithshëm të planifikimit, mbledhjes, përpilimit, (ri) vlerësimit, zbulimit dhe analizimit të të dhënave demografike, ekonomike dhe sociale në nivelin më të ulët gjeografik, që në një periudhë të caktuar kohore, zbatohen për të gjithë personat në një vend ose në një pjesë veçanërisht të kufizuar të një vendi”.⁶ Thelbi i një shpjegimi kaq të thjeshtë qëndron në nevojën kryesore pas procesit të mbledhjes së të dhënave, e që është **bazë për prodhimin dhe shpërndarjen e pasurisë materiale**. Për të planifikuar zbatimin afatgjatë dhe të detajuar të zhvillimit ekonomik dhe social, veprimtarive administrativo-burokratike ose punës kërkimore-shkencore, është thelbësore të kemi të dhëna të besueshme dhe shteruese për madhësinë, shpërndarjen dhe përbërjen e popullsisë së një zone gjeografike të kufizuar. I organizuar

5 Department of Economic and Social Affairs Statistics Division, *Principles and Recommendations for Population and Housing Censuses. Revision 3, 2017*, mund të gjendet në: https://unstats.un.org/unsd/demographic-social/Standards-and-Methods/files/Principles_and_Recommendations/Population-and-Housing-Censuses/Series_M67rev3-E.pdf (datë: 13 dhjetor 2021)

6 Ibid, f. 2

në një periudhë prej të paktën dhjetë vjetësh, çdo regjistrim duhet të përfshijë në të dhënat e mbledhura numrin e njerëzve, shpërndarjen e tyre hapësinore, strukturën e moshës dhe gjinisë, si dhe kushtet e tyre të jetesës dhe karakteristika të tjera kryesore socio-ekonomike. Në këtë kuptim, mbledhja e të dhënave në nivel kombëtar duhet parë si një proces ekskluzivisht shkencor-statistikor, qëllimi përfundimtar i të cilit është:

- 1) lehtësimi i zbatimit dhe funksionimit të administratës publike,
- 2) rinovimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i statistikave kombëtare (me referencë të veçantë për komponentët socio-ekonomikë të informacionit të mbledhur) dhe
- 3) krijimi i një baze për kërkime dhe analiza të projektimit.

Edhe pse perceptohet si një referencë kyçe për planifikimin e së ardhmes së një vendi, është e rëndësishme të theksohet se procesi i regjistrimit është gjithashtu i rëndësishëm për ruajtjen dhe zhvillimin e kapaciteteve demokratike. Devijimet që mund të rezultojnë nga keqpërdorimi, paplotësia ose falsifikimi i të dhënave mund të dëmtojnë ndjeshëm stabilitetin politik, rendin dhe paqen publike në një vend, veçanërisht nëse popullsia është e shtresuar në baza racore, etnike, fetare, gjuhësore ose kulturore.

Regjistrimet e popullsisë në Kosovë

Përkundër faktit se regjistrimi i numrit dhe strukturës së popullsisë në kuptimin modern nuk është bërë para vitit 1921, shembujt historikë tregojnë se ka pasur përpjekje për të përcaktuar numrin e përafërt të banorëve në Kosovë. Kështu, gjatë sundimit të Perandorisë Osmane, por edhe në Kosovë, gjatë shekullit IXX dhe XX, janë kryer tri regjistrime të përgjithshme të popullsisë (1831, 1881/82 dhe 1905/06), ku janë mbledhur të dhëna për vendin e lindjes, moshën, gjininë, vendbanimi, profesionin/zanatin, statusin martesor, gjendjen shëndetësore dhe përkatësinë fetare.

Në mbështetje të faktit se regjistrimi ishte një faktor i rëndësishëm në jetën e përditshme, ai tregon se personave të regjistruar në Perandorinë Osmane u jepeshin të ashtuquajturat certifikatat e regjistrimit të identitetit (tur. *nüfus tezkeresi*), që kishin rolin e certifikatave të lindjes dhe letërnjoh-timeve bashkëkohore, dhe ishin të detyrueshme në kryerjen e punëve shtetërore dhe juridike.

Vendosja e një rendi të ri ndërkombëtar pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore dhe tendencat e papritura demografike të shkaktuara nga pasojat shkatërruese të luftës dhe lëvizjet migratore, krijuan nevojën për mbledhjen e të dhënave statistikisht të sakta dhe gjithëpërfshirëse. Të dhëna të tilla në rrethanat e ndryshuara drastike të pasluftës supozohej se do të shërbenin si inxhinieri stimuluese socio-ekonomike, e cila nga ana tjetër do të mundësonte një rikuperim të shpejtë nga pasojat e Luftës së Madhe. Në rrethana të tilla, në Kosovë regjistrimi i popullsisë u krye në periudhën ndërmjet luftërave të Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve, gjegjësisht Mbretërisë së Jugosllavisë (që nga viti 1929), gjatë viteve 1921 dhe 1931. Uvertura e Luftës së Dytë Botërore, kohëzgjatja dhe pasojat e saj e bënë të pamundur mbajtjen e duhur të regjistrimit në mbarë Evropën, dhe në Kosovë (si një njësi e veçantë territoriale), tani në kuadër të Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë (FPRY), u mbajt tre vite pas përfundimit të luftës - 1948. Pastaj, pasuan regjistrimet e viteve 1953, 1961, 1971, 1981 dhe 1991 në kuadër të RPFJ-së dhe RSFJ-së (Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë). Në një vorbull mosmarrëveshesh politike dhe retorikës së ndezur nacionaliste regjistrimi i popullsisë i vitit 1991 në Kosovë nuk u krye tërësisht për shkak të bojkotit nga pjesëtarët e komunitetit shqiptar dhe konflikteve ndëretnike dhe ushtarake të viteve 1990, dhe fërkimet gjatë dekadës së parë të shekullit XXI kushtuan që regjistrimi i parë i ardhshëm të mbahet dy dekada më vonë, përkatësisht në vitin 2011. Në kapitujt në vijim do të paraqiten rezultatet e cikleve të regjistrimeve të lartcekura të popullsisë në Kosovë për periudhën ndërmjet viteve 1921 dhe 2011.

Regjistrimet e popullsisë para vitit 2011

Regjistrimi i popullsisë në Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve është bërë në vitin 1921 pa mbledhjen e të dhënave për përkatësinë etnike, por ekskluzivisht për gjuhën amtare dhe fenë. Rezultatet e regjistrimit të popullsisë, të publikuar në vitin 1924, treguan se në Kosovë jetojnë 329.502 pjesëtarë të bashkësisë fetare islame, 93.203 ortodoksë, 15.785 katolikë, 427 hebrenj dhe 26 katolikë grekë. Sa i përket gjuhës amtare, 288.907 qytetarë flisnin shqip, 114.095 serbisht, 27.915 turqisht, 402 arumune (ose cincare), 184 sllovenisht, 30 gjermanisht dhe hungarisht 12.

● 1921

Rezultatet e regjistrimit të popullsisë, të publikuar në vitin 1924, treguan se në Kosovë jetojnë:

- **329.502** pjesëtarë të bashkësisë fetare islame,
- **93.203** ortodoksë,
- **15.785** katolikë,
- **427** hebrenj dhe
- **26** katolikë grekë.

Sa i përket gjuhës amtare:

- **288.907** qytetarë flisnin shqip,
- **114.095** serbisht,
- **27.915** turqisht,
- **402** arumune (ose cincare),
- **184** sllovenisht,
- **30** gjermanisht dhe
- **12** hungarisht.

Figura 1. Rezultatet e regjistrimit të vitit 1921 në bazë të fesë në Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve në territorin e Kosovës së sotme.




Figura 2. Rezultatet e regjistrimit të popullsisë të vitit 1921 në bazë të gjuhës amtare në Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve në territorin e Kosovës së sotme.





Figura 3. Rezultatet e regjistrimit të vitit 1931 në bazë të fesë në Mbretërinë e Jugosllavisë në territorin e Kosovës së sotme.



Në regjistrimin e vitit 1931, qytetarët kishin të drejtë të shprehnin përkatësinë e tyre etnike. Megjithatë, gjatë deklarimit, fillimisht qytetarëve iu ofrua të konfirmojnë nëse kombësia e tyre ishte jugosllave apo tjetër, kështu që vetëm pyetja e radhës në pyetësor ofronte mundësinë e regjistrimit të pavarur të kombësisë. Kjo praktikë është pasojë e propagandës së identitetit jugosllav që pasoi me ndryshimin e emrit të vendit në vitin 1929 dhe ndryshimin e rrjedhës së çështjes kombëtare në atë të krijimit shumëkombësh.⁷ Sipas rezultateve të atij regjistrimi, në Kosovë kishte gjithsej 552,064 banorë, prej të cilëve në bazë të besimit fetar: 379,981 myslimanë, 150,745 ortodoksë, 20,568 katolikë dhe 770 qytetarë të besimit të feve të tjera.⁸ 331,549

⁷ Snežana Mrđen, Narodnost u popisima. Promjenljiva i nestalna kategorija, Filozofski fakultet Zadar, 2002, f. 78, mund të gjendet në: <http://www.doiserbia.nb.rs/img/doi/0038-982X/2002/0038-982X0201077M.pdf> (datë: 17 dhjetor 2021)

⁸ Republički zavod za statistiku, Stanovništvo po veroispovesti i maternjem jeziku po popisu od 31. marta 1931. godine, mund të gjendet në: <http://publikacije.stat.gov.rs/G1931/Pdf/G19314001.pdf> (datë: 21 dhjetor 2021)

banorë të Kosovës flisnin shqip, serbisht (dhe gjuhë të tjera sllave të jugut)⁹ 180,170, hungarisht 426, gjermanisht 241, ndërsa 38,907 nuk u deklaruan detajisht rreth gjuhës së tyre amtare.

● 1931 552,064 BANORË

→ **379,981** myslimanë


→ **150,745** ortodoksë

→ **20,568** katolikë

→ **770** qytetarë të besimit të feve të tjera

⁹ Ashtu si në rastin e deklarimit të shtetësisë, zgjedhja e gjuhës amtare kushtëzohet nga zgjedhja ndërmjet *gjuhëve jugosllave dhe të tjera*, dhe të dhënat e mbledhura për gjuhët ishin jo të plota, sepse qytetarët e shprehnin gjuhën e tyre amtare ndryshe dhe sipas gjykimit të tyre, ose nuk specifikonin fare se cilën gjuhë sllave të jugut përdorin.

Figura 4. Rezultatet e regjistrimit të vitit 1931 në bazë të gjuhës amtare në Mbretërinë e Jugosllavisë në territorin e Kosovës së sotme.



Krahas mbledhjes së të dhënave për numrin e përgjithshëm të popullsisë dhe strukturën e popullsisë, regjistrimi i vitit 1948 kishte për qëllim të vlerësonte shkallën e pasojave dhe dëmeve të shkaktuara nga lufta në territorin e gjithë RPFJ-së së atëhershme. Nga të dhënat e grumbulluara është konstatuar se në Kosovë jetojnë gjithsej 727,820 persona, prej të cilëve: shqiptarë (498,242), serb (171,911), malazez (28,050), rom (11,230), të ashtuquajtur myslimanë të papërcaktuar (9,679)¹⁰, kroatë (5,290), turq (1,315), maqedonas (526), sllovenë (283), gjermanë (197) dhe të tjerë (1,816).¹¹

¹⁰ Nga qytetarët e RPFJ-së, të cilët janë të besimit islam dhe etnisë sllave jugore, kërkohet që në një rubrikë të veçantë gjatë regjistrimit të zgjedhin opsionin e ofruar (mysliman-i papërcaktuar, serb-mysliman, kroat-mysliman, maqedonas-mysliman etj.) ose të shkruajnë se janë të kombësisë së papërcaktuar.

¹¹ Republički zavod za statistiku, *Stanovništvo narodnosti po popisu od 15. marta 1948. godine*, mund të gjendet në: <http://publikacije.stat.gov.rs/G1948/Pdf/G19484001.pdf> (datë: 21 dhjetor 2021)

1948 727,820 BANORË

- shqiptarë (498,242)

- serb (171,911)

- malazez (28,050)

- rom (11,230)

- të ashtuquajtur myslimanë të papërcaktuar (9,679)

- kroatë (5,290)

- turq (1,315)


- maqedonas (526)

- sllovenë (283)

- gjermanë (197)

- dhe të tjerë (1,816)

Figura 5. Rezultatet e regjistrimit të popullsisë të vitit 1948 në bazë të përkatësisë etnike në RPFJ-së në territorin e Kosovës së sotme.



Për të shmangur ndërprerjen e regjistrimit dhe për t'iu përshtatur praktikës ndërkombëtare, RPFJ vetëm pesë vite pas regjistrimit të mëparshëm në vitin 1953 mbajti një regjistrim tjetër. Në territorin e Kosovës kishte gjithsej 808,141 banorë dhe struktura në baza etnike ishte si në vijim: shqiptarë (524,559), serbë (189,969), turq (34,583), malazezë (31,343), romë (11,904), jugosllavë/të papërcaktuar (6,241)¹², kroatë (6,201), maqedonas (972), sllovenë (511), të tjerë (1,858).¹³ Siç ishte rasti me regjistrimin e vitit 1948, edhe në vitin 1953, qytetarët nga rrallët e korpusit etnik të sllavëve të jugut të besimit islam u detyruan të zgjedhin njëren nga kategoritë e

¹² "Një person me origjinë jugosllave, i cili nuk është i vendosur kombëtarisht, regjistrohej: Jugosllav-i papërcaktuar, dhe personi i papërcaktuar kombëtarisht regjistrohej: i papërcaktuar kombëtarisht." (nga: Savezni zavod za statistiku, *Popis stanovništva 1953. godine. Knjiga I. Vitalna i etnička obeležja. Konačni rezultati za FNRJ i narodne republike*, Beograd, 1959, f. 9)

¹³ Republički zavod za statistiku, *Stanovništvo po veroispovesti i maternjem jeziku po popisu od 31. marta 1931. godine*, mund të gjendet në: <http://publikacije.stat.gov.rs/G1948/Pdf/G19484001.pdf> (datë: 21 dhjetor 2021)

● 1953 808,141 BANORË

→ shqiptarë (524,559)

→ serbë (189,969)

→ turq (34,583)

→ malazezë (31,343)

→ romë (11,904)

→ jugosllavë/të papërcaktuar (6,241)


→ kroatë (6,201)

→ maqedonas (972)

→ sllovenë (511)

→ të tjerë (1,858)

Figura 6. Rezultatet e regjistrimit të vitit 1953 në bazë të përkatësisë etnike në RFPJ në territorin e Kosovës së sotme.



ofruara, më së shpeshti atë të ashtuquajturën të *papërcaktuar*. Në anën tjetër, gjatë vitit 1953, pjesëtarët e komunitetit goran, i cili në atë kohë ende nuk njihet si grup i veçantë etnik, në viset ku jetojnë tradicionalisht (komuna e sotme e Dragashit) kryesisht u deklaruan si turq.

Në regjistrimin e vitit 1961 është konstatuar se Kosova ka një popullsi prej 963,959 banorë, ku nga numri i përgjithshëm 646,604 shqiptarë, 227,016 serbë, 37,588 malazezë, 25,764 turq, 8,026 myslimanë, 7,251 kroatë, 5,206 jugosllavë, 3,202 romë, 1,142 maqedonas, 510 sllovenë, ndër- sa grupet tjera etnike 1,650¹⁴.

14 Republički zavod za statistiku, Popis stanovništva, domaćinstava, i stanova u 1961. godini. Nacionalni sastav stanovništva FNR Jugoslavije. Podaci po naseljima i opštinama. Knjiga III, Beograd, 1994, mund të gjendet në: <http://publikacije.stat.gov.rs/G1961/Pdf/G19614001.pdf> (datë: 22 dhjetor 2021)

1961 963,959 BANORË

→ **646,604** shqiptarë

→ **227,016** serbë

→ **37,588** malazezë

→ **8,026** myslimanë

→ **7,251** kroatë

→ **5,206** jugosllavë


→ **3,202** romë

→ **1,142** maqedonas

→ **510** sllovenë

→ **1,650** grupet tjera etnike

Figura 7. Rezultatet e regjistrimit të vitit 1961 në bazë të përkatësisë etnike në RFPJ në territorin e Kosovës së sotme.



Në vitin 1971, në materialet e regjistrimit, pra në pyetësorë figuron termi *përkatësia etnike*, gjë që nuk ishte rasti në ciklet e mëparshme të mbledhjes së të dhënave (kur u përdor termi kombësia). Një risi tjetër është mungesa e ofrimit të shembujve të emrave të grupeve etnike dhe secilit individ i jepet mundësia të shprehë lirisht përkatësinë e tij etnike (d.m.th. "Sipas deklaratës së personit të regjistruar"). Rezultatet e regjistrimit të vitit 1971 treguan një rritje të madhe të popullsisë së Kosovës, e cila në atë vit ishte mbi një milion dhe arriti në gjithsej 1,243,693 banorë. Pjesën më të madhe të popullsisë e përbënin shqiptarët (916,168), të ndjekur nga serbët (228,264), malazezët (31,555), myslimanët (26,357), romët (14,953), turqit (12,283), kroatët (8,264), maqedonasit (1,048), jugosllavët (920), sllovenët (392) dhe të tjerë (3,489).¹⁵

¹⁵ Republički zavod za statistiku, *Popis stanovništva, domaćinstava, i stanova u 1971. godini. Nacionalni sastav stanovništva SFR Jugoslavije. Podaci po naseljima i opštinama. Knjiga III*, Beograd, 1994, mund të gjendet në: <http://publikacije.stat.gov.rs/G1971/Pdf/G19714001.pdf> (datë: 22 dhjetor 2021)

1971 1,243,693 BANORË

→ 916,168 shqiptarë

→ 228,264 serbë

→ 31,555 malazezë,

→ 26,357 myslimanë

→ 14,953 romë

→ 12,283 turq

→ 8,264 kroatë


→ 1,048 maqedonas

→ 920 jugosllavë

→ 392 sllovenë

→ 3,489 të tjerë

Figura 8. Rezultatet e regjistrimit të vitit 1971 në bazë të përkatësisë etnike në RSFJ në territorin e Kosovës së sotme.



Krahasuar me vitin 1971, rezultatet e regjistrimit të vitit 1981 tregojnë një rënie të ndjeshme të përqindjes së serbëve në popullatën e përgjithshme të Kosovës nga 23% në 18%. Popullsia u rrit në pothuajse një çerek milioni brenda një dekadë, duke arritur në 1,584,440. Nga këta, shqiptarë ishin 1,226,736, serbë – 209,497, myslimanë – 58,562, romë – 34,126, malazezë – 27,028, turq – 12,513, kroatë – 8,718, jugosllavë – 2,676, maqedonas – 1,056, slovenë - 343 dhe të tjerë – 3,185. Ndryshe nga të gjitha ciklet e mbledhjes së të dhënave të kryera më parë, në vitin 1981, për herë të parë, qytetarëve iu ofrua e drejta për të mos deklaruar identitetin e tyre. Përveç kësaj, ky ishte një regjistrim në të cilin myslimanët sllavë të jugut kishin të drejtë të deklaroheshin sipas grupit etnik që paraprakisht ishte bërë kategori kushtetuese - myslimanë.

Klima e paqëndrueshme politike e krijuar nga pasojat e zgjedhjeve të para të mbajtura në mënyrë demokratike dhe armiqësitë ndëretnike në rritje në RSFJ hodhën një hije mbi regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe bane-

save gjatë vitit 1991. Presioni i opsioneve politike etnocentrike mbi votuesit e tyre për t'u deklaruar në listë në përputhje me retorikën e tyre të zgjuar nacionaliste ka marrë hov dhe presioni më i madh është ushtruar mbi ata që në ciklin e kaluar u deklaruan si jugosllavë.¹⁶

Në të kundërt, pakënaqësia e përhapur në mesin e shqiptarëve të Kosovës është shkaktuar nga kufizimet drastike të autonomisë së KA të Kosovës, dhe vendimi për të mos marrë pjesë në punën e institucioneve ka rezultuar me bojkot të plotë të procesit të regjistrimit nga ky komunitet. Kështu, ndryshe nga pjesa tjetër e ish-RSFJ-së, mbledhja në terren e të dhënave për numrin dhe strukturën e popullsisë në Kosovë ishte plotësisht e pasuksesshme. Byroja e atëhershme Federale e Statistikave ofroi vlerësimin e saj për numrin e pjesëtarëve të komunitetit shqiptar në Kosovë¹⁷,

¹⁶ Snežana Mrđen, *Narodnost u popisima. Promjenljiva i nestalna kategorija*, Filozofski fakultet Zadar, 2002, f. 90, mund të gjendet në: <http://www.doiserbia.nb.rs/img/doi/0038-982X/2002/0038-982X0201077M.pdf> (datë: 12 janar 2022)

¹⁷ Republički zavod za statistiku, *Stanovništvo i domaćinstva Republike Srbije prema popisu 1991. godine*, Beograd, 1995.

dhe këto të dhëna jo të plota për strukturën etnike kryqëzoheshin me të dhënat e mbledhura gjatë vitit 1991, në mesin e pjesës së popullsisë që nuk e bojkotoi regjistrimin.¹⁸ Kështu, struktura numerike dhe etnike në Kosovë është vlerësuar si vijon: shqiptarë – 1,596,072, serbë – 194,190, myslimanë – 66,189, romë – 45,745, malazezë – 20,365, kroatë – 8,062, jugosllavë – 3,457 dhe të tjerë – 21,933.

Regjistrimi i Popullsisë dhe ekonomive familjare në vitin 2011

Për shkak të luftës dhe ndërhyrjes së NATO-s në fund të viteve 1990, si dhe përpjekjeve për të ndërtuar paqen nën kujdesin e bashkësisë ndërkombëtare, kushtet themelore të sigurisë, administrative dhe procedurale për kryerjen e regjistrimit të popullsisë në vitin 2001 në Kosovë nuk ekzistonin.

Për shkak të mungesës së një kuadri institucional dhe administrativ për përpunimin e të dhënave statistikore, në vitin 2001 u krijua *Enti i Statistikës së Kosovës* (sot *Agjencia e Statistikave të Kosovës*). Ky organ rregullator (në kuadër të sistemit të UNMIK-ut) synoi të krijonë para-kushtet themelore për përgatitjen dhe zbatimin e mëvonshëm të një regjistrimi gjithëpërfshirës në Kosovë. Në bashkëpunim me subjektet ndërkombëtare, Kuvendi i Kosovës në vitin 2003 miratoi *Ligjin për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë*, me synim të rregullimit, organizimit dhe realizimit të regjistrimit dhe përcaktimit e kuadrit institucional-administrativ dhe kompetencave të organeve përkatëse, të cilat do të garantonin përgatitjen, zbatimin dhe monitorimin e këtij procesi në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare.

mund të gjendet në: <https://publikacije.stat.gov.rs/G1995/Pdf/G19954001.pdf> (datë: 19 dhjetor 2021)

18 Republički zavod za statistiku, *Stanovništvo prema nacionalnoj pripadnosti. Popis 1991.*, mund të gjendet në: <https://www.stat.gov.rs/media/3637/stanovnistvo-prema-nacionalnoj-pripadnosti-popis-1991.xlsx> (datë: 22 dhjetor 2021)

Në bazë të Ligjit të vitit 2003, Kuvendi i Kosovës në vitin 2010 miratoi një ligj të ri *Ligji për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave* (nr. 03/L-237)¹⁹, përmbajtja e të cilit nuk ka pësuar ndryshime të mëdha, ndërsa cilësia shumë e dobët e përkthimeve në gjuhën serbe ka mbetur konstante. Pakuptueshmëria dhe paqartësitë në përmbajtjen e ligjit nuk ishin e vetmja arsye pse nuk u krye një regjistrim plotësisht legjitim në vitin 2011. Gjegjësisht, në katër komuna në veri të Kosovës (Mitrovicë të Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan) nuk është bërë regjistrimi i popullsisë, ndërsa shumica e pjesëtarëve të komunitetit serb që jetojnë në jug të lumit Ibër në mënyrë të konsiderueshme e bojkotuan këtë proces. Se bojkoti nuk ishte befasi tregon edhe fakti se serbët e Kosovës bojkotuan pesë teste përgatitore në terren për regjistrimin e popullsisë që u mbajtën në zonat me shumicë serbe në vitin 2006 dhe 2008.


Përkundër strategjisë së zhvilluar qartë të Entit të Statistikës të Kosovës (të publikuar në vitin 2009)²⁰, ku u propozua një plan i detajuar i fushatës publike që synonte informimin e qytetarëve serbë për rëndësinë e pjesëmarrjes në regjistrim, pati pak pasoja dhe mirëkuptim në mesin e pjesëtarëve të këtij komuniteti. Sipas *Raportit përfundimtar të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për regjistrimin e kryer*, pikërisht mospjesëmarrja e serbëve të Kosovës në regjistrim u shënuar si dështimi më i madh që kishte për pasojë fushatën e papërshtatshme publike. Mirëpo, pavarësisht mungesës së pjesëmarrjes së popullatës, u vlerësua se organizimi i regjistrimit funksionoi mirë dhe se stafi i regjistrimit kishte arritur rezultate të kënaqshme²¹. Gjithashtu, u theksua se mbledhja funksionale e të dhënave dhe menaxhimi i dokumenteve të regjistrimit mundësoi

19 Kuvendi i Kosovës, *Ligji për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave*, 2010, mund të gjendet në: <http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-237-ser.pdf> (datë: 21 dhjetor 2021)

20 Statistical Office of Kosovo, *Proposal of a Road Map for the Population and Housing Census in Kosovo*, 2009, Pristina

21 Kosovo Agency of Statistics, *Kosovo Population and Housing Census 2011. Final Results, 2011*, f. 22, mund të gjendet në: https://ask.rks-gov.net/media/2075/final-results_eng.pdf (datë: 21 dhjetor 2021)

Figura 9. Rezultatet e regjistrimit të vitit 2011 sipas përkatësisë etnike në Kosovë.



krijimin e një baze elektronike të të dhënave të pa ekzistuar më parë, e cila do të "lehtësojë ndjeshëm ciklin e ardhshëm të regjistrimit".

Rezultatet e regjistrimit të vitit 2011 nga publiku i gjerë në Kosovë, si dhe nga bashkësia ndërkom-bëtare u njohën si legjitime. Sipas këtyre rezultateve, struktura etnike tregoi se shumica e popullsisë janë shqiptarë (92.93%), ndërsa një numër i konsiderueshëm i pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë janë boshnjakë (1.58%), serbë (1.58%), turq (1.08), ashkali (0.89%), egjiptianë (0.66%), romë (0.51%) dhe goranë (0.59%).²²²³


22 Agjencia e Statistikave të Kosovës, *Popullsia sipas gjinisë, etnicitetit dhe vendbanimit*, Prishtinë, 2013, e qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/media/1615/stanovnistvo-prema-polu-i-nacionalnosti-na-nivou-naselja.pdf> (datë: 21 dhjetor 2021)

23 Në numra, rezultatet e regjistrimit të vitit 2011 janë si në vijim: gjithsej 1,739,825 banorë, nga të cilët: shqiptarë – 1,616,869, romë – 34,126, boshnjakë – 27,533, serbë – 25,532, turq – 18,738, ashkali – 15,436, egjiptianë – 11,524, goranë – 10,265, të tjerë – 20,225.

Shtirja e kufizuar e regjistrimit të vitit 2011 ka bërë të nevojshme një vlerësim të popullsisë totale ndërmjet dy cikleve të regjistrimit. Përveç Agjencisë së Statistikave të Kosovës, vlerësimet e ofruar nga OSBE-ja dhe ECMI-a konsiderohen të jenë një nga më relevante dhe më të përafërta. Sipas këtij vlerësimi (të vitit 2013), struktura e popullsisë sipas përkatësisë etnike është si vijon: shqiptarë (86.6% - 1,623,419), serb (7.8% - 146,128), boshnjak (1.5% - 28,933), turq (1% - 18,948), romë (0.8% - 15,696), ashkali (0.8% - 15,546), egjiptian (0.6% - 11,524) dhe goranë (0.5% - 10,945)²⁴ Duke pasur parasysh trendin e ndjeshëm dhe valët e migrimit nga Kosova jashtë vendit, pavarësisht nga etniciteti, të cilit shpesh i paraprin graviteti i brendshëm drejt qyteteve më të mëdha (nga rurale në urbane), është jashtëzakonisht e vështirë të jepet një vlerësim i përafërt i popullsisë rezidente të Kosovës.

24 European Center for Minority Issues Kosovo, *Communities in Kosovo: A guidebook for professionals working with communities in Kosovo*, Prishtina, 2013, mund të gjendet në: <https://www.ecmikosovo.org/uploads/ECMIKosovoDec2013Guidebookfor-ProfessionalsENG.pdf> (datë: 21 dhjetor 2021)


Figura 10. Vlerësimi i vitit 2013 nga ECMI dhe OSBE për numrin e popullsisë sipas përkatësisë etnike në Kosovë.



Situata me pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës është specifike në atë që është pak më e ndërlikuar në krahasim me pjesëtarët e komunitetit shumicë. Mungesa e sigurisë personale dhe ligjore, një mjedis i trazuar politik, një situatë e palakmueshme ekonomike, si dhe izolimi social, gjuhësor dhe kulturor (veçanërisht i përhapur në mesin e serbëve që jetojnë në enklavat në jug të lumit Ibër) e bëjnë të vështirë që ky komuniteti të mbijetojë në

Kosovë. Për më tepër, pasojat e konflikteve të fundit të viteve të 90-ta dhe trazirave të marsit të vitit 2004 i motivojnë më tej pjesëtarët e këtij komuniteti që të kërkojnë një jetë më të mirë jashtë Kosovës. Me rritjen e shpejtë të popullsisë së re të serbëve të Kosovës që largohen nga Kosova (përkohësisht ose në mënyrë të pakthyeshme), aktualisht është e pamundur të vlerësohet numri i saktë i pjesëtarëve të këtij komuniteti joshumicë.

Figura 11. Raporti krahasues në mes të komuniteteve shumicë, serbëve dhe komuniteteve tjera jo-shumicë në Kosovë bazuar në regjistrimet e vitit 1971, 1981, 1991. (vlerësimi²⁵), 2006. (vlerësimi²⁶) dhe 2013. (vlerësimi²⁷).



Pa u mbështetur tërësisht në argumentet e mësipërme, dhe me qëllim të përcaktimit të saktë të numrit të banorëve të katër komunave në veri të Kosovës, në Kuvendin e Kosovës në vitin 2016, është dorëzuar iniciativa për miratimin e të ashtuquajturit *Ligjit për regjistrimin e popullsisë në veri*.²⁸

Një nga argumentet kryesore në favor të realizimit të regjistrimit në zonën e katër komunave në veri të Kosovës ishte harmonizimi i numrit real të banorëve me buxhetet komunale atje. Përkundër ekzistimit të hendekut mes këtyre dy faktorëve, dhe jo vetëm në këto komuna, propozimi i këtij ligji nuk është miratuar. Dështimi i kësaj nisme vonoi mbledhjen e të dhënave gjithëpërfshirëse deri në ciklin e ardhshëm të regjistrimit të popullsisë. Edhe pse gjatë vitit 2019, Agjencia e Statistikave të Kosovës njoftoi se në bazë të këshillave të Eurostat-it dhe standardeve ndërkombëtare, çdo hap dhe aktivitet që ishte planifikuar në detaje me qëllim të

25 Republički zavod za statistiku, *Stanovništvo i domaćinstva Republike Srbije prema popisu 1991. godine*, Beograd, 1995, mund të gjendet në: <https://publikacije.stat.gov.rs/G1995/Pdf/G19954001.pdf> (datë: 11 dhjetor 2021)

26 Enti i Statistikës së Kosovës, *Ndryshimet demografike të popullsisë së Kosovës në periudhën 1948-2006, 2008*, mund të gjendet në: <https://ask.rks-gov.net/media/2065/demografske-promene-kosova-u-periodu-1948-2006.pdf> (datë: 11 janar 2022)

27 European Center for Minority Issues Kosovo, *Community Profiles, 2016*, mund të gjendet në: <https://www.ecmikosovo.org/en/Community-Profiles> (datë: 11 janar 2022)

28 Kos.Sev, *Srbi sa Severa neće na kosovski popis i ne veruju da*

će ga biti, 2016, mund të gjendet në: <https://kossev.info/srbi-sa-severa-nece-na-kosovski-popis-i-ne-veruju-da-ce-ga-biti-2/> (datë: 11 janar 2022)

realizimit të regjistrimit të vitit 2021 (d.m.th. 2022) do të zbatohet siç është planifikuar, ndërsa korniza ligjore që ligjërisht do të përfundojë përpjekjet e tilla ende nuk është miratuar (maj 2022).

Regjistrimi i vitit 2011 prodhoi implikime praktike në disa fusha:

- mungesa e të dhënave për popullatën e përgjithshme, si dhe për një numër të pa definuar të serbëve, si komunitetit më të madh joshumicë në Kosovë, rrjedhimisht krijoi një keqkuptim për raportin real statistikor ndërmjet komuniteteve shumicë dhe joshumicë;
- shpërndarje të pabarabartë të buxhetit nga niveli qendror në atë të komunave me shumicë serbe (veçanërisht ato në veri të Kosovës), për shkak të parimit se grantet buxhetore llogariten në bazë të numrit të popullsisë së një komune, gjë që pengon zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik të tyre dhe funksionimin e administratave lokale;
- përjashtimi i personave të zhvendosur (që banojnë në Serbi ose Kosovë) dhe personave që jetojnë në Kosovë vetëm gjatë periudhave të caktuara kohore (p.sh. për shkak të kushteve ekonomike) nga pjesëmarrja në regjistrim;
- përjashtimi, në disa raste, i serbëve nga procesi i regjistrimit për shkak të posedimit të dokumenteve personale të lëshuara nga Serbia;
- thellimi i mëtejshëm i problemeve pronësore dhe juridike që për dy dekada mundojnë pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës.

Projektligji për regjistrimin e popullsisë dhe perspektivat për mbajtjen e regjistrimit në Kosovë

Fusha e organizimit, zbatimit dhe monitorimit të regjistrimit gjithmonë rregullohet me ligjin për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave. Ndryshimet në rrethanat socio-politike

dhe nevoja për rregullim praktik të ciklit të ardhshëm të regjistrimit kërkojnë sigurimin e mbarrëvajtjes së regjistrimit duke përcaktuar rregulla të qarta ligjore nga organet legjislative. Ndërkohë, përveç informacioneve individuale të publikuara në media për kohëzgjatjen e regjistrimit (në periudhën prej 30 ditësh, krahasuar me vitin 2011, kur ishte 15 ditë)²⁹, buxhetit të përafërt në dispozicion (rreth 11 milionë euro)³⁰ dhe veprimet përgatitore, opinioni në Kosovë nuk ishte i informuar në detaje për regjistrimin e ardhshëm. Siç thuhet në *Planin vjetor të statistikave zyrtare* të Agjencisë së Statistikave të Kosovës³¹, për vitin 2020 është planifikuar miratimi i projektligjit për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, si dhe realizimi i një regjistrimi pilot. Në plan thuhet se këto aktivitete me siguri do të shtyhen për një kohë të pacaktuar (për shkak të pandemisë).

Për shkak të paqëndrueshmërisë politike dhe ndryshimeve në koalicionet qeverisëse në një periudhë të shkurtër kohore, si dhe shfaqjes së virusit COVID-19 në Kosovë, miratimi i ligjit të ri që do të rregullonte në detaje procesin e regjistrimit që është shtyrë disa herë. Prandaj, më 28 dhjetor 2021, Qeveria dërgoi në Kuvend shqyrtimin e projektligjit për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave³². Pas përcaktimit të përputhshmërisë së projektligjit me standardet e BE-së³³, propozimi u shqyrtua nga komisioni përkatës parlamentar dhe më 23 shkurt 2022 Kuvendi në parim miratoi projekt-

29 KosSev, *Digitalni popis stanovništva na Kosovu ove godine, čeka se usvajanje Zakona, 2022*, mund të gjendet në: <https://kossev.info/digitalni-popis-stanovnistva-na-kosovu-ove-godine-čeka-se-usvajanje-zakona/> (datë: 11 janar 2022)

30 Agjencia e Statistikave të Kosovës, *Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare 2021, 2020*, mund të gjendet në: <https://ask.rks-gov.net/media/5472/plani-vjetor-2021-ke-srb-02062020.pdf> (datë: 12 janar 2022)

31 Agjencia e Statistikave të Kosovës, *Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare 2021, 2020*, mund të gjendet në: <https://ask.rks-gov.net/media/5472/plani-vjetor-2021-ke-srb-02062020.pdf> (datë: 12 janar 2022)

32 Kuvendi i Kosovës, *PROJEKTIGJI PËR REGJISTRIMIN E POPULLSISË, EKONOMIVË FAMILJARE DHE BANESAVE*, mund të gjendet në: https://kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/PLperregjistriminepopullsisë,ekonomive-familjaredhebnesave_zsEUCszgXs.pdf (datë: 7 mars 2022)

33 Kuvendi i Kosovës, *Mendimi juridik rreth Projektligjit për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, 2021*, mund të gjendet në: https://kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/114pravnomisljenje_hXvBD8tpGb.pdf (datë: 7 mars 2022)

ligjin (nr. 08/L-114) për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave³⁴. Megjithatë, vetë procedura e miratimit përfundimtar të ligjit është shtyrë, pavarësisht se për përgatitjen dhe zbatimin e procesit funksional të regjistrimit nevojiten së paku gjashtë muaj. Në përputhje me nenin 57 të Rregullores së Kuvendit³⁵, pas miratimit të projektligjit në seancën e parë, Kuvendi është i detyruar të shqyrtojë më tej projektligjin, përmes angazhimit të një komisioni funksional (raportues) dhe komisioneve të përhershme: për buxhet dhe financa, legjislativ, për integrim evropian, si dhe për të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Pas miratimit në parim, bordi funksional është ligjërish i detyruar që në afat jo më të gjatë se dy muaj³⁶ të ofroi një raport përfundimtar me ndryshime dhe plotësime për projektligjin dhe më pas ta dorëzoi në procedurë për shqyrtim të dytë në Kuvend.

Megjithatë, miratimi përfundimtar i projektligjit nuk u bë në kohën e publikimit të këtij hulumtimi dhe informacioni më i fundit i disponueshëm për publikun mbi progresin në këtë proces³⁷ ishte se anëtarët e grupit funksional më 5 maj 2022, rishikuan përmbajtjen e projektligjit. Por pavarësisht nga zhvillimi i skenarëve që çojnë në miratimin përfundimtar të ligjit, planet, hapat dhe afatet e renditura në *Hartën rrugore* për regjistrimin e popullsisë dhe ekonomive *shtëpiake*³⁸ nuk janë respektuar, megjithëse edhe vetë dokumenti është përditësuar në korrik të vitit 2020 për t'iu

34 Kuvendi i Kosovës, *Vendim për miratimin në parim të projektligjit nr. 08/L-114, 2022*, mund të gjendet në: https://kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/114Vendimpermiratimneparim_KTe5yrrNEJ.pdf (datë: 7 mars 2022)

35 Kuvendi i Kosovës, *Rregullorja e Punës së Kuvendit*, 2010, mund të gjendet në: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/6/Rr_K_RK_29_04_2010_3_XRyC2ppcHm.pdf (datë: 7 mars 2022)

36 Komisionet e mësipërme mund të kërkojnë një periudhë shtesë prej një muaji për të paraqitur raportin e tyre me plotësime dhe ndryshime.

37 Kuvendi i Kosovës, *Projektligji nr. 08/L-114 për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, 2022*, mund të gjendet në: <https://kuvendikosoves.org/srb/predlozi-zakona-i-zakoni/predlozi-zakona/?draftlaw=352#info-div> (datë: 10 maj 2022)

38 Agjencia e Statistikave të Kosovës, *REGJISTRIMI I POPULLSISË NË KOSOVË 2021 Harta rrugore për regjistrimin e popullsisë dhe ekonomive shtëpiake*, 2018, mund të gjendet në: <https://ask.rks-gov.net/media/5557/serb-harta-rrugore-e-regjistrimit-te-popullsisë-me-2021-azhurnuar-ne-korrik-020-srb.pdf> (datë: 12 mars 2022)

përshtatur rrethanave të reja të krijuara nga pandemia. Ndonëse gjatë muajit gusht të vitit 2021, Agjencia e Statistikave të Kosovës deklaroi se dy nga katër fazat e përgatitjes dhe zbatimit të regjistrimit praktikisht kanë përfunduar, dhe se i ashtuquajti regjistrimi pilot (shtator-tetor 2020) është kryer³⁹, opinioni nuk ishte i informuar me kohë për ecurinë në këto faza e aq më pak për përgatitjen e publikut për regjistrimin e ardhshëm. Miratimi i buxhetit, digjitalizimi i plotë i procesit dhe krijimi i një sërë dokumentesh të brendshme të Agjencisë së Statistikave të Kosovës nuk janë parakusht i mjaftueshëm për mos informimin e qytetarëve për këtë proces të rëndësishëm statistikor.

Para kësaj, ishte e nevojshme të bëhen disa ndryshime në draftin e lartpërmendur, i cili në fakt është bazë ligjore për eliminimin e çdo parregullsie të mundshme dhe kontrollin e cilësisë së zhvillimit të procesit të regjistrimit. Si një akt që duhet të rregullojë në mënyrë koncize dhe precize procesin statistikor të mbledhjes së të dhënave dhe angazhimit institucional, ai lejon një sërë paqartësish që në fazat fillestare të regjistrimit dhe përdorimi përfundimtar i të dhënave të mbledhura mund të krijojë dyshime dhe vakum ligjor. Në këtë kuptim, nga këndvështrimi i serbëve (dhe komuniteteve të tjera joshumicë) artikujt dhe përkufizimet individuale mund të krijojnë hapësirë për manovrim për interpretime të ndryshme (të gabuara):

- **POPULLSIA REZIDENTE DHE JOREZIDENTE.** Përkufizimi i propozuar i këtyre dy kategorive nuk përfshin personat që u larguan nga Kosova si rezultat i luftës në fund të viteve 1990 dhe pas 17 marsit 2004 dhe që kanë statusin e refugjatit (kudo që janë aktualisht). Nga ana tjetër, në dritën e të drejtave të personave rezidentë për të ofruar të dhënat e tyre në mungesë të individëve jorezidentë, të drejtat e personave të zhvendosur në rrethana të tilla

39 AlInfo.ch, *Shtyhet sërish regjistrimi i popullsisë në Kosovë, 2021*, mund të gjendet në: <https://www.alinfo.ch/shtyhet-serish-regjistrimi-i-popullsisë-ne-kosove/> (datë 21 mars 2022)

ngushtohen deri në pikën e mungesës së qasjes në procesin e regjistrimit. Kjo e fundit mund të jetë veçanërisht e vërtetë për mjediset ku personat që mund (në emër të tyre) të plotësojnë një pyetësor regjistrimi në mungesë të personave të zhvendosur. Për më tepër, kategoritë e tilla pak të përcaktuara të popullsisë nuk lejojnë pjesëmarrjen e atyre personave, më së shpeshti të kthyerve në pjesën perëndimore të Kosovës, të cilët banojnë në Kosovë në intervale të caktuara sezonale. Problemi mund të lindë kur këto intervale nuk përkojnë me mbledhjen e të dhënave njëmuore brenda procesit të regjistrimit të popullsisë (kur ai të përcaktohet).

- **SUBJEKTI I REGJISTRIMIT.** Neni 6 i Projektligjit thekson se "regjistrimi përfshin popullsinë, ekonominë familjare dhe banesat/shtëpitë në territorin e Kosovës". E përcaktuar në këtë mënyrë, lënda e regjistrimit nuk lejon, si në kategoritë e mësipërme, përfshirjen gjithëpërfshirëse të personave të zhvendosur në regjistrim. Përveç kësaj, i gjithë projektligji gjithashtu nuk ofron modalitete për të renditur pronën e shkatërruar ose të uzurpuar, ku aktualisht rastet aktive⁴⁰ në Kosovë janë 12,823.
- **KOMPETENCA E AGJENCISË SË STATISTIKAVE TË KOSOVËS.** Pavarësisht nga roli dhe kompetencat e përcaktuara qartë të Agjencisë, nuk është e qartë se në çfarë mënyre dhe në bazë të cilave kriteret ky organ do të zgjedhë regjistruerit (nga lista e përzgjedhur e paraqitur), dhe kur bëhet fjalë për komunat me shumicë apo prani të konsiderueshme të komuniteteve joshumicë. Gjithashtu, është e diskutueshme nëse respektimi i kuotave për pjesëtarët e këtyre komuniteteve që do të marrin pjesë në regjistrim të popullsisë do të monitorohet nga organet mbikëqyrëse.

40 Stefan Surlić i Igor Marković, *Imovinska prava na Kosovu u okviru sveobuhvatne normalizacije odnosa Beograda i Prištine*, Nacionalni konvent o Evropskoj uniji za poglavlje 35, 2021, f. 10, mund të gjendet në: http://www.ngoaktiv.org/uploads/files/Imovinska_prava_na_Kosovu_u_okviru_sveobuhvatne_normalizacije_odnosa_Beograda_i_Pristine.pdf (datë: 14 shkurt 2022)

- **KOMISIONET KOMUNALE TË REGJISTRIMIT.** Sipas projektligjit, formimi i komisioneve komunale do të pasqyrojë strukturën etnike të popullsisë së secilës njësi të vetëqeverisjes. Megjithatë, nuk saktësohet nëse struktura do të përcaktohet në bazë të rezultateve të regjistrimit të mëparshëm apo në bazë të vlerësimit të lirë të vetëqeverisjes lokale. Në të dyja rastet, në komunitetet dhe komunat serbe të Kosovës mund të formohen komisione joproporcionale në dëm të pjesëtarëve të këtij komuniteti. Ky skenar është i mundur duke marrë parasysh praktikën aktuale të përdorimit të rezultateve të regjistrimit (të bojkotuar më parë) si burim relevant për vendimmarrje, veçanërisht në nivel lokal. Në të kundërt, rregulli që kërkon që numri i anëtarëve për komunë të përcaktohet në bazë të numrit të përgjithshëm të popullsisë të publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në vlerësimet e saj vjetore është inkurajues. Megjithatë, nga ana tjetër, e drejta për të emëruar një përfaqësues të shoqërisë civile (si dhe anëtarë të tjerë) nga kryetari i komunës, si anëtar i lartë të komisionit komunal, mund të vërë në dyshim objektivitetin e këtyre organeve duke pasur parasysh ndikimin e mundshëm politik. Kjo e fundit mund të shërbejë veçanërisht si paralajmërim nëse kemi parasysh faktin se komisionet komunale kanë një rol të rëndësishëm në përzgjedhjen e regjistruerëve, si dhe koordinojnë dhe monitorojnë aktivitetet gjatë fazave të ndryshme të numërimit, të cilat në fund mund të ndikojnë në cilësinë e zbatimit të duhur të tij.
- **SANKSIONET KUNDËRVAJTËSE ME GJOBË.** "Personi i cili refuzon t'i jap të dhënat që i kërkon regjistruerit ose personi tjetër i autorizuar për Regjistrim, ose me vetëdije jep informata të pakompletuara dhe të pasakta, dënohet" me gjobë nga 30 deri në 5,000 euro për individët ose 500 deri në 20,000 euro për personat juridikë. Mungesa e sqarimeve për nivelet e

shkeljeve dhe si pasojë e gjobave mund të keqpërdorohet gjatë çdo faze të regjistrimit. Veçanërisht të cenueshme në këtë drejtim mund të jenë kategoritë e personave të zhvendosur që nuk janë të informuar për datën e saktë të mbledhjes së të dhënave personale, në rast të mungesës fizike të tyre.

- **DOKUMENTET PERSONALE.** Drafti nuk përcakton saktësisht se cilat dokumente personale do të përdoren për identifikim gjatë mbledhjes së të dhënave. Personat që aktualisht nuk kanë dokumente personale të Kosovës mund të përjashtohen në mënyrë indirekte nga procesi i regjistrimit.
- **FUSHATA INFORMATIVE.** Edhe pse neni 17 thotë se Agjencia e Statistikave të Kosovës është përgjegjëse për kryerjen e një "fushate të gjerë të sensibilizimit" për procesin e regjistrimit (bazuar në strategjitë e tij), projektligji nuk ofron zgjidhje se cili organ do të jetë përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe dinamikën e fushatës informuese, veçanërisht të asaj të zhvilluar në mjediset e banuara nga komunitetet joshumicë. Megjithatë Zyra e Komisionit për Gjuhët mund të luajë një rol të rëndësishëm në këtë proces, veçanërisht kur bëhet fjalë për kontrollin e shpërndarjes së informacionit në gjuhën amtare të komuniteteve. Projektligji dhe Strategjia nuk ofrojnë mekanizma të kontrollit të cilësisë dhe respektimin e të drejtës së komunitetet joshumicë për informacionin në gjuhën amtare.

Këshilli Konsultativ për Komunitete, si institucion që kujdeset për interesat e komuniteteve joshumicë në Kosovë, ka paraqitur komentet e tij për Projektligjin dhe ka ofruar zgjidhje që do të marrin parasysh interesat dhe nevojat e asaj pjese të popullatës. Ndër të tjera, ky organ propozoi si në vijim:

- të dhënat e mbledhura gjatë regjistrimit të zgjerohen në një numër kategorish të reja (arsyeja e mungesës nga vendbanimi i zakonshëm, arsyeja e zhvendosjes, profili i arsimit, etj.),

- të obligohen të gjitha institucionet relevante që të respektojnë Ligjin për përdorimin e gjuhëve gjatë procesit të regjistrimit,
- të dhënat për banorët jorezidentë, gjegjësisht ish anëtarët e ekonomive familjare të futen në një listë të veçantë plotësuese (për të lehtësuar diferencimin ndërmjet kategorive të banorëve rezidentëve),
- në kuadër të Komisionit Qendror dhe Komunal të Regjistrimit, të përfshihet së paku një përfaqësues nga komuniteti joshumicë,
- pjesëtarët e komuniteteve joshumicë duhet të përfshijnë së paku 10% të personelit të regjistrimit,
- gjobat për refuzimin e pjesëmarrjes në regjistrim të ulen prej 500 deri në 1,000 euro, me arsye të precizuara për mospjesëmarrje dhe kategorizim të gjobave.

Rekomandimet dhe sugjerimet e lartpërmendura potencialisht do të përmirësonin kushtet për regjistrimin e qytetarëve që nuk i përkasin komunitetit shumicë dhe në këtë mënyrë do të kontribuonin në arritjen e rezultateve përfundimtare më të sakta.

Pa paragjykuar dinamikën e vazhdimit të procesit të miratimit të Projektligjit në Kuvend, dhe duke gjykuar nga detyrimi i përcaktuar në propozimin e dhënë (që koha dhe afati i regjistrimit duhet të përcaktohet nëntë muaj para datës së regjistrimit), nuk ka gjasa që procesi i regjistrimit, të paktën procesi i rregullt, të bëhet para vitit 2023. Këtu shtohet fakti se regjistrimi po vonohet në të gjitha fazat përgatitore, dhe mundësia që qytetarët të jenë dëshmitarë edhe të një shtyrje të regjistrimit të popullsisë në Kosovë ekziston.

5. Qëndrimet e serbëve të Kosovës lidhur me regjistrimin e ardhshëm të popullsisë

Qëllimi dhe metodologjia e hulumtimit

Ky hulumtim synon, siç është përmendur tashmë, të plotësojë një nga aspektet e temave kërkimore në kuadër të projektit OPEN 2021, i cili ka për qëllim matjen e hapjes së komunitetit serb të Kosovës. Hulumtimi u fokusua në qëndrimet, interesat, dëshirat dhe frikën e pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës për pjesëmarrjen e tyre (të mundshme) në regjistrimin e popullsisë, i cili planifikohet të bëhet në vitin 2022. Më saktësisht, hulumtimi është përpjekur të identifikojë faktorët kyç që do të ndikonin në vendimin e serbëve të Kosovës për të marrë pjesë në regjistrim. Në këtë kuptim, qasja dhe metoda gjithëpërfshirëse kërkimore siguron bazën për ofrimin e një pasqyre mbi perceptimet dhe qëndrimet e pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës mbi rëndësinë e procesit të regjistrimit për të ardhmen e tyre në Kosovë nga perspektiva dhe dimensione të ndryshme: socio-ekonomike, politike, juridiko-burokratike dhe identitare-kulturore. Gjithëpërfshirja e qasjes, në mungesë të plotë të kërkimeve mbi këtë temë bazohet në nevojën për kërkime të thelluara në komunitet, e

cila duhet të bëhet pikënisje për përcaktimin dhe hartëzimin e qëndrimeve dhe nevojave autentike të këtij komuniteti në lidhje me regjistrimin. Rezultatet e hulumtimit në parim tregojnë arsyet dhe argumentet kryesore të serbëve të Kosovës, dhe ku vendimmarrësit duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë, veçanërisht atyre subjekteve që deklarativisht apo realisht përfaqësojnë interesat e këtij komuniteti joshumicë. Krahas krijimit të bazës për të ndikuar në vendimmarrje, hulumtimi synon gjithashtu të informojë publikun e gjerë për qëndrimet e panjohura deri më tani të serbëve të Kosovës për pjesëmarrjen në regjistrimin e ardhshëm.

Kjo është arritur përmes qasjeve të ndryshme metodologjike në kuadër të aktiviteteve kërkimore sasiore dhe cilësore. Një qasje e tillë kërkonte zhvillimin e të ashtuquajturit *desk reseach* - përkatësisht kërkimit ligjor, dokumentar, statistikor dhe analitik që synon të analizojnë natyrën, zhvillimin, strukturën dhe pasojat e regjistrimeve të mëparshme në Kosovë, por edhe kornizën aktuale ligjore që (potencialisht) mund të paracaktojë mënyrën se si do të kryhet regjistrimi. Pas kësaj faze hulumtuese, partnerët

në hulumtim - OJQ AKTIV dhe QDKP - me pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës zhvilluan intervista cilësore të thelluara dhe fokus grupe, të plotësuara nga rezultatet sasore të mbledhura përmes nismës OPEN. Në bazë të kësaj qasjeje metodologjike, gjetjet e hulumtimit të kryer janë ndarë në ato të karakterit sasior dhe cilësor.

Gjetjet sasore të hulumtimit

Siç u theksua në paragrafët e mëparshëm, nisma avokuese OPEN realizoi një anketë gjithëpërfshirëse të pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës për të përcaktuar pikëpamjet e

tyre për personat e pagjetur, përkatësinë etnike, tolerancën ndërfetare, sigurinë, llogaridhënien e akterëve politikë, pjesëmarrjen e qytetarëve në politikë dhe procese vendimmarrëse, punën e institucioneve, lirinë e fjalës dhe mbrojtjen e mjedisit. Në të njëjtën kohë, qytetarëve u përgjigjen edhe në pyetjet e mbyllura për perceptimin e faktorëve dhe elementëve të ndryshëm që lidhen ngushtë me procesin e regjistrimit të popullsisë. Gjatë anketës, qytetarëve iu ofruan opsione për t'u deklaruar për pjesëmarrjen (e mundshme) në regjistrim (dhe faktorët që mund të ndikojnë në një vendim të tillë), si dhe për t'u informuar për procesin e regjistrimit dhe qëllimin e tij.

Figura 12. Pyetja e anketës: "A do të merrni pjesë në regjistrimin e ardhshëm të popullsisë në Kosovë?"



Qytetarët janë të vetëdijshëm se nëse nuk marrin pjesë në regjistrim, i mohojnë vetes të drejtën për shumë përfitime që vijnë drejtpërdrejt nga mospjesëmarrja në regjistrim. Për shembull, buxheti në komunat serbe është i kushtëzuar nga numri i banorëve.

- STUDENT

Gjykuar nga rezultatet e anketës, afër gjysma e qytetarëve (**47.6%**) konfirmoi se do të marrë pjesë në regjistrimin e ardhshëm të popullsisë në Kosovë. Një e treta e përqindjes në mesin e qytetarëve të anketuar (**35.4%**), të cilët nuk kanë vendosur ende nëse do të bojkotojnë regjistrimin apo jo, argumenton se institucionet përkatëse dhe akterët politikë duhet të përqendrohen dhe të investojnë përpjekje dhe logjistikë shtesë për t'i informuar rreth rëndësisë së pjesëmarrjes (por edhe për gjordat që mund të pasojnë për një vendim tjetër). Nga ana tjetër, vendimi për bojkotim personal të procesit të regjistrimit u shpreh nga **17%** të anketuarve. Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit që morën pjesë në hulumtim ndanë interpretime të ndryshme të këtyre rezultateve. Shumica pajtohet se, sipas tyre, "përqindja e lartë" e atyre që (me shumë gjasa) do të marrin pjesë është një tregues i ndryshimeve të rëndësishme në komunitetin serb të Kosovës dhe se, sipas fjalëve të një pjesëmarrësi që jeton në jug të lumit Ibër, "në këtë kuptim, procesi i integritit të [serbëve] në sistemin e Kosovës definitivisht ka marrë hov".

Të tjerët, megjithatë, shprehën frikën se rezultate të tilla në fakt ishin reflektim i ndarjeve të thella brenda komunitetit dhe injorancës së konsiderueshme të qytetarëve për zhvillimet thelbësore politike dhe të tjera shoqërore në Kosovë. Një nga vëzhgimet që mund të vihet re në mesin e një numri të konsiderueshëm të pjesëmarrësve të fokus grupeve është se qytetarët që ende nuk kanë vendosur presin që Beogradi t'u bëjë thirrje serbëve të Kosovës që të (mos) bojkotojnë regjistrimin, ndërsa në mesin e atyre që kanë vendosur të mos marrin pjesë në regjistrim janë të rinjtë (të cilët janë kryesisht të painformuar dhe të pa interesuar) dhe njerëz që "ende i rezistojnë integritit në institucionet e Kosovës". Megjithatë, shumica e pjesëmarrësve të fokus grupeve dyshojnë në besueshmërinë e këtij rezultati, sepse, nga këndvështrimi i tyre, "përqindjet në realitet ndryshojnë shumë dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet autentike të komunitetit tonë".

Kundër këtij qëndrimi, pati një sërë përgjigjesh uniforme nga ekspertë të intervistuar nga fusha



Ky qëndrim i qytetarëve të veriut të Kosovës buron nga fakti se ata ende shpresojnë që i ashtuquajtur i veriu do t'i takoj Serbisë, ndërsa populli në jug të lbrtit e di se procesi i integritit institucional ka përfunduar dhe se të njëjtit i janë nënshtruar para veriut - më shumë se dhjetë vjet më parë.

- NJË AKTIVIST I VJETËR NGA VERIU

të ndryshme të ekspertizës. Gjegjësisht, gjatë hulumtimit është konstatuar se të dhënat e mbledhura nuk ngjallin dyshime, dhe se rezultatet e mësipërme nuk i befasojnë aspak. Si një argument kyç në favor të një pozicioni kaq të qëndrueshëm në mesin e të intervistuarve, është se regjistri "ende nuk është një temë prioritare", nga ku edhe rrjedh "divergjenca relative e opinioneve të të anketuarve". Megjithatë, edhe pse pyetja për përgjigjen e mundshme të qytetarëve në regjistrim nuk u shtrua gjatë intervistës, disa ekspertë me iniciativën e tyre deklaruan se ajo do të ishte pozitive, duke lëvizur ndërmjet 65% dhe 90% të qytetarëve serbë.

Duke analizuar rezultatet e pyetjes së parë të anketës për zonën e regjistrimit në kategori të ndryshme, të dhënat e mbledhura treguan dallime në qëndrimet e grupeve individuale shoqërore. Përgjigje pozitive në pyetjen për pjesëmarrjen në regjistrim të qytetarëve mbi 66 vjeç dhanë **62.5%** të anketuarve, për bojkot **12.5%**, ndërsa të pavendosur ishin **25%**. Në anën e kundërt të shkallës, është e rëndësishme të theksohet se përqindjet më të larta në mesin e atyre që kishin qëndrim pro bojkotit janë të vetëpunësuarit me orar jo të plotë (**23.5%**) dhe të papunët në kërkim të punësimit (**28.1%**). Dallimi në nivelin e personave të pavendosur u vu re te personat me arsim të lartë (**42.4%**), me status më

të mirë ekonomik (**43.5%**), tek studentët (**46.3%**), gratë (**48.1%**) dhe amviset (**64%**).

Të dhënat, ndër të cilat u theksuan dallimet e dukshme, janë ato në mesin e përgjigjeve të qytetarëve që jetojnë në jug dhe në veri të lumit Ibër. Përderisa serbët e Kosovës që jetojnë në jug me shumicë dërrmuese votuan pro - **73.9%** (13.3% u përgjigjën negativisht, dhe 12.8% ishin të pavendosur), bashkatdhetarët e tyre nga veriu zgjodhën një përqindje pozitive në një përqindje shumë më të vogël - **32.8%**, me **48.1%** të pavendosur (dhe 19.1% për bojkotin). Një ish-punëtor në disa organizata ndërkombëtare në Kosovë ka deklaruar se "ky dallim ka ekzistuar edhe gjatë regjistrimit të vitit 2011, kur UNOPS-i duhej të bënte regjistrimin në veri të Kosovës, por kryetarët e katër komunave në veri të Kosovës refuzuan ta mbështesin regjistrimin për shkak se ishte sipas ligjeve të Kosovës. Është e qartë se arsyeja për qëndrimet e ndryshme në veri dhe në jug të lbrit është e rrënjosur kryesisht në realitetet e

ndryshme politike, të sigurisë dhe socio-ekonomike në të cilat ata jetojnë. Ish-profesori universitar gjithashtu e mbështet këtë argument, duke theksuar se "thelbi i problemit qëndron në faktin se serbët që jetojnë në jug të lbrit (veçanërisht ata në enklavat jashtë komunave me shumicë serbe) varen nga donacionet dhe projektet infrastrukturore të institucioneve të Kosovës, ku shërbime administrative ofrohen në kuadër të institucioneve në të cilat serbët janë të nënëpërfaqësuar ose të papërfaqësuar fare - që do të thotë se ata nuk vendosin plotësisht për fatin e tyre". Në atë boshllëk ndërmjet veriut dhe jugut, bashkëbiseduesit përkatës, si dhe bashkëbiseduesit e tjerë, shohin konfirmimin e qëndrimeve të tyre në rezultatin konkret të anketës, duke vënë në dukje se në veri të lumit Ibër qytetarët në çdo rast mbështeten më shumë në sugjerimet e Beogradit, dhe për këtë arsye është edhe ky numër i konsiderueshëm i të papërcaktuarve në katër komuna në veri të Kosovës.

Figura 13. Pyetja e anketës: "A jeni njoftuar për kohën dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrimit të ardhshëm të popullsisë në Kosovë?"





Figura 14. Pyetja e anketës: "A e dini pse bëhet regjistrimi i popullsisë?"



Duke konfirmuar mungesën e një fushate publike dhe diskutimi mbi regjistrimin, si dhe pikëpamjet e shprehura gjatë intervistave dhe fokus grupeve, dallimet drastike në përqindje kur anketohen qytetarët për (mos)informimin e tyre vazhdimisht përvijojnë pasqyrën e përgjithshme. Ky pretendim mbështetet nga fakti se në raport me rezultatin e përgjithshëm të anketës nuk kishte as devijimeve më të vogla ndërmjet kategorive të ndryshme të qytetarëve të anketuar.

Fokus grupet theksuan faktin se shumica dërrmuese e të anketuarve kanë njohuri bazë për qëllimin dhe objektivat e mbajtjes së regjistrimit si një praktikë statistikore e praktikuar në mbarë botën. Rezultatet e anketës treguan se qytetarët serbë në Kosovë kryesisht janë të njohur me funksionet themelore të regjistrimit, siç tregohet

nga përqindja e të anketuarve që plotësisht (**34.8%**) dhe pjesërisht (**36.8%**) njohin thelbin e atij procesi. Megjithatë, ekziston një përqindje e konsiderueshme e atyre (**20.8%**) të cilët nuk kanë një informacion të tillë. Ndër të anketuarit që shprehën siguri të plotë në përgjigjen e tyre ndaj pyetjes ishin njerëz që janë relativisht të qëndrueshëm financiarisht ("Unë mund të sigurojë shumicën e gjërave që dua") - **59.4%**, ndërkohë që e njëjta përgjigje nga ana e kundërt e shkallës ekonomike ("Kam probleme për të ushqyer veten dhe familjen time») ishte një përqindje tjetër - **12.5%**. Të anketuarit nga kjo kategori ekonomikisht të rrezikuar, **59.4%**, theksuan se nuk ishin në dijeni për qëllimin e mbajtjes së regjistrimit të popullsisë, ndërkohë që një përqindje edhe më e lartë është vërejtur te personat me arsim të papërfunduar - **75%**.

Grafiku 15. Pyetja e anketës: "Në një shkallë nga 1 deri në 5 (ku 1 është rezultati më i ulët dhe 5 është rezultati më i lartë), rrethoni pikën që përshkruan se si faktorët e ofruar do të ndikojnë në vendimin tuaj për të marrë pjesë në regjistrimin e ardhshëm të popullsisë?"





Figura 16. Pyetja e anketës: "A do të ndikohet vendimi juaj për të marrë pjesë në regjistrimin e ardhshëm nga ftesa zyrtare e Beogradit?"



Kur bëhet fjalë për cilësinë e shpjegimeve dhe udhëzimeve për pjesëmarrjen në regjistrim, si një faktor që do të ndikonte potencialisht në vendimin e të anketuarve, shkalla e përgjigjeve është mjaft e larmishme dhe nuk lë vend për përfundime të përgjithësuara dhe prirje drejt një boshti të caktuar. Ka dallime ndërmjet pjesës veriore dhe jugore të Kosovës, ku dy pikët më të ulëta nuk përputhen: veri - **29.1%**, jug - **67.7%**. Rreth ndikimit të qëndrimeve personale në temën e këtij hulumtimi përqindja më e madhe është përgjigjur me mendim negativ - **38.8%**, ku përqindja e personave me arsim të lartë arrin në **49.8%**, dhe në mesin e atyre që refuzuan të komentojnë situatën personale ekonomike arrin në **80%**. Duke gjykuar nga rezultatet e anketës, situata e sigurisë do të

gjeneronte një ndikim vendimtar në vendimin për pjesëmarrje në regjistrim, sepse për opsionet e ofruara në shkallën nga 3 deri në 5 u përcaktuar **79.6%** të të anketuarve. Notën më të lartë në mesin e amvisave (5) kishte përqindja prej **60%**. Pasqyrimi i orientimit drejt boshtit të vlerësimit më të lartë u reflektua në mënyrë të ngjashme në vlerësimin e efektit të rëndësisë së ruajtjes së të drejtave të garantuara me ligj dhe Kushtetutë - **77.8%**, si dhe nevoja për të përcaktuar numrin e përgjithshëm të serbëve që jetojnë në Kosovë - **80.6%**. Që frika nga gjrobat si pasojë e një bojkoti personal të regjistrimit nuk do të ketë një ndikim më të madh në vendim në krahasim me faktorët e tjerë të ofruar në anketë, tregon shumën e dy vlerësimeve më të ulëta - **46.8%**.



Mendoj se në përgjithësi rekomandimi i Beogradit nuk do të ketë shumë ndikim. Gjithmonë do të ketë nga ata që nuk do ta marrin parasysh atë rekomandim.

- PUNËTOR NË MEDIAT LOKALE

Shumica e të anketuarve (**44.4%**) janë të mendimit se ftesa e Beogradit për (mos) pjesëmarrje në regjistrimin e ardhshëm nuk do të jetë një faktor vendimtar, afërsisht një e treta (**31%**) nuk ka qëndrim për këtë çështje, ndërsa një e katërta e të anketuarve (**24.6%**) pretendon se ftesa zyrtare e Beogradit do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen personale. Përderisa përgjigjet e të anketuarve në veri të lbrit janë më afër rezultatit përfundimtar (po - 34.1%; jo - 39.1%; pa qëndrim - 26.9%), të anketuarit në jug të Kosovës thanë ndryshe - po (**7.8%**), jo (**53.9%**), pa qëndrim (**38.3%**). Vendimi i Beogradit ka ndikimin më të vogël të mundshëm në mesin e punonjësve me orar jo të plotë - po **7%**, jo **65.1%**. Hendeku i brezave vihet re në mungesë të qëndrimit, ku mbizotërojnë studentët me **48.8%**, dhe me përqindje më të ulët janë pensionistët prej **12.3%**, përkatësisht brezat mbi 60 vjeç - **15.3%**. Rezultatet sasiore përkonin ndjeshëm me pikëpamjet e pjesëmarrësve në fokus grup. Përderisa ekzistonte një ndarje e qartë (dhe e arsyetuar) midis atyre për të cilët vendimi i Beogradit do të luante një rol kyç, të pavendosurit këmbëngulnin në të drejtën e secilit për të vendosur individualisht, bazuar në parametra të ndryshëm, dhe jo domosdoshmërisht në qëndrimin e Beogradit. Qëndrime të ngjashme janë vërejtur në mesin e të intervistuarve lidhur me mungesën e deklarimit të Beogradit për regjistrimin e ardhshëm në Kosovë, gjë që mund të përmblihet në përgjigjen e punëtores së intervistuar të arsimit: "Unë mendoj se Beogradi do të jetë i rezervuar deri në fillim të regjistrimit dhe do ta kalkulojë këtë çështje në procesin e bisedimeve. Përfaqësuesit e serbëve të Kosovës janë të vetëdijshëm për pasojat që do të shkaktonte

mospjesëmarrja në regjistrim, kështu që nëse nuk ka ftesë publike për pjesëmarrje nga Beogradi, të paktën ajo do të kalojë me pëlqim të heshtur.

Gjetjet cilësore të hulumtimit

Duke plotësuar gjetjet sasiore me ato cilësore, ky hulumtim synoi të hedhë dritë mbi të gjithë spektrin e dukurive që lidhen drejtpërdrejt me procesin e mbledhjes, në dukje të thatë, statistikore të të dhënave për numrin dhe strukturën e popullsisë. Këtij qëllimi i shërbyen tetë fokus grupe dhe dymbëdhjetë intervista të kryera në mjedis të Kosovës të banuara kryesisht nga pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës. Reagimet e dhëna gjatë aktiviteteve kërkimore për qëllimet e këtij botimi ndonjëherë rezononin me disonancën e mendimeve të ndryshme dhe reciprokisht kontradiktore, të mbushura me supozime ose me mungesë të plotë pikëpamjesh. Falë shumëllojshmërisë së opinioneve të shprehura gjatë hulumtimit, u arrit të nxirren pikëpamjet kryesore të komunitetit serb në lidhje me regjistrimin e ardhshëm në Kosovë. Këto pikëpamje u ndanë në disa fusha tematike kornizë, të cilat më së shumti mbështeteshin në pyetjet e bëra gjatë fokus grupeve dhe intervistave.

Regjistrimi i bojkotuar i viti 2011

Krahasuar me pikëpamjet e të anketuarve për regjistrimin e ardhshëm, çështja e bojkotimit të regjistrimit të vitit 2011 nxiti pikëpamje më kontradiktore. Kjo është kryesisht pasojë, siç është theksuar në disa raste, e rrethanave specifike politike dhe të sigurisë që përcaktuan karakterin e dështimit (të pjesshëm) të procesit të regjistrimit. Pikërisht për këtë u pajtuan qëndrimet e pjesëmarrësve të fokus grupeve dhe ekspertëve të intervistuar, të cilët ndër të tjera theksuan se vendimi për bojkot shkaktoi pasoja të gjera që hapën një rrugë të shtrembëruar për integrimin e serbëve në mekanizmat institucionalë të Kosovës.



Qoftë regjistrimi i vitit 2011 apo 2022, sigurisht që nuk ka rëndësi se cili është qëndrimi juaj për bojkotin, sepse në të dyja rastet gjithçka varet nga fakti nëse Beogradi dhe Prishtina, me ndërmjetësimin e BE-së, bien dakord rreth organizimit dhe pjesëmarrjes së papenguar të serbëve në procesin e regjistrimit të popullsisë.

- PUNËTOR NË NJË INSTITUCION KULTUROR

Si argumenti më i mbizotëruar për avantazhet dhe disavantazhet e bojkotit të regjistrimit gjatë vitit 2011, ishte për buxhetet komunale të reduktuara në mënyrë drastike të alokuara në bazë të të dhënave jo të plota të regjistrimit. Përderisa për disa privimi prej dekadash i burimeve të konsiderueshme financiare shënoi një mundësi të humbur për zhvillim dhe përparim ekonomik, për të tjerët ishte vetëm një nga shumë probleme me të cilat ballafaqohen pjesëtarët e komunitetit serb në Kosovë që nga përfundimi i luftës.

Në përputhje me trendin që u vu re shkurtimisht gjatë procesit të hulumtimit, nuancat në dallimet në qëndrimet e njerëzve që jetojnë në jug dhe veri të lbrit u pasqyruan edhe në bojkotin e vitit 2011. Qëndrimet e të anketuarve nga katër komunat veriore u karakterizuan me harmonizim në aspektin e mbështetjes absolute dhe shënimit të bojkotit si "një akt plotësisht korrekt". Nga ana tjetër, bashkatdhetarët e tyre në jug kishin mendime të ndara për bojkotin, duke iu rikthyer argumentit të reduktimit të buxheteve të pushteteve lokale me shumicë serbe. Një jurist nga një prej komunat e intervistuar gjatë hulumtimit theksoi se kjo e fundit rrjedh nga "fakti i distancës kohore të proceseve integruese në jug të lumit Ibër të nisura shumë më herët se në veri", duke shtuar se «injeksionet financiare të Beogradit në veri të

Kosovës praktikisht e kanë amortizuar pakën-aqësinë e mundshme për mungesën e granteve buxhetore [të Kosovës] në katër komuna".

Pjesëmarrja e personave të zhvendosur

Si një nga kategoritë më të cenueshme brenda komunitetit serb të Kosovës, personat e zhvendosur pashmangshëm kanë qenë temë gjatë aktiviteteve kërkimore. Përkundër faktit se tema e pjesëmarrjes së personave të zhvendosur ishte sugjeruar paraprakisht në pyetjet e fokus grupeve dhe intervistave, të anketuarit që në fillim theksuan rëndësinë e përfshirjes së personave të zhvendosur në procesin e regjistrimit, kudo që ata jetojnë aktualisht. Të gjithë ekspertët e intervistuar u pajtuan se është e nevojshme të gjenden modalitete adekuate për pjesëmarrjen e tyre, gjë që do të përshpejtonte ndjeshëm procesin e kthimit, i cili "aktualisht është në telashe të mëdha". Sipas fjalëve të juristit nga veriu i Kosovës, i cili beson se aktualisht nuk ka kushte elementare ligjore apo administrative për pjesëmarrjen e kësaj kategorie të njerëzve në procesin e regjistrimit, "është e nevojshme të miratohen rregullore ligjore që do të lejonin serbët e zhvendosur dhe të gjithë qytetarët e tjerë të Kosovës të marrin pjesë në regjistrim". Si argument vendimtar, pjesëmarrësit e hulumtimit theksuan se personat e zhvendosur nuk janë larguar nga Kosova me vullnetin e tyre të lirë dhe se e drejta e tyre për t'u regjistruar rrjedh prej asaj, që "në një afat të gjatë do të mundësonte qasje më të lehtë në dokumentet e Kosovës, pronë private apo të uzurpuar, e si rrjedhojë do të kontribuonte në kthimin e qëndrueshëm". Ndryshe nga këto pretendime, një nga juristët e intervistuar shprehu dyshime për mundësinë e përfshirjes së personave të zhvendosur që nuk jetojnë dhe banojnë në Kosovë në procesin e regjistrimit dhe se si një praktikë e tillë eventualisht do të bëhej një precedent që do rezultonte në një raport joproporcional të numrit popullsisë rezidente dhe jorezidente. Megjithatë, kishte lënë hapësirë që nëse komuniteti ndërkombëtar është i interesuar për përfshirjen



Besoj se çdo person që ka të drejtë dhe i plotëson kushtet për marrjen e dokumenteve të Kosovës apo që i posedon, duhet të marrë pjesë dhe duhet të ketë të drejtë të marrë pjesë, pavarësisht nga vendbanimi apo vendqëndrimi aktual.

- PJESËMARRËS I GRUPIT TË FOKUSIT

e personave të zhvendosur, të ndërmjetësorë në zgjidhjen e problemit që aktualisht është “në një vakum ligjor”.

Roli i komunitetit ndërkombëtar

Të pyetur për të komentuar rolin e mundshëm të komunitetit ndërkombëtar në procesin e përgatitjes, zbatimit dhe monitorimit të regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, të anketuarit ofruan përgjigje të ndryshme, duke komentuar avantazhet dhe disavantazhet e mundshme të rolit të tyre pasiv apo aktiv në të. Një pjesë më e vogël e të anketuarve pohuan se roli i tepruar i organizatave ndërkombëtare në regjistrim mund të krijojë një imazh negativ publik, pasi prania e tyre e dukshme do të mbështeste argumentin se institucionet e Kosovës nuk janë të gatshme të mbledhin siç duhet të dhënat në mbarë Kosovën. I njëjti grup si argument kundër përfshirjes së komunitetit ndërkombëtar theksoi se regjistrimi i popullsisë nuk është homolog i zgjedhjeve politike dhe se nuk ka nevojë për ndërhyrje të jashtme të çfarëdo lloji, përveç në procesin e monitorimit (që është praktikë e zakonshme në shumë vendet në tranzicion të Evropës Lindore).

Një numër i madh i të anketuarve nuk u pajtuan, duke besuar se prania e komunitetit ndërkombëtar në çfarëdo forme ishte e nevojshme

për mbarëvajtjen e regjistrimit, i cili nuk do të rëndohej nga ndikimi i intrigave politike dhe presionit mbi komunitetet joshumicë. Ky qëndrim mbështetet nga pretendimi i përsëritur shpesh se komuniteti ndërkombëtar është garantuesi i vetëm i paqes në Kosovë dhe se ka besimin e pothuajse të gjitha komuniteteve në Kosovë. Fjala kyçe e lidhur me përfitimet e përfshirjes së komunitetit ndërkombëtar në regjistrim ishte rregullsia. Sipas pjesëmarrësve në hulumtim, fakti që për herë të parë i gjithë procesi u digjitalizua kërkon masa shtesë paraprake që do të kontribuonin në mbledhjen e të dhënave të sakta, në vlefshmërinë e të cilave askush nuk do të dyshonte. Përveç kësaj, të anketuarit u pajtuan se komuniteti ndërkombëtar mund të kontribuojë në procesin e regjistrimit duke ofruar mbështetje financiare dhe logjistike për një fushatë sensibilizuese rreth rëndësisë së pjesëmarrjes së pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë (në gjuhën amtare). Ndër të tjera, disa të anketuar sugjeruan që vëzhguesit nga Serbia të përfshihen në misionet ndërkombëtare të monitorimit, detyra e të cilëve do të ishte monitorimi i regjistrimit të serbëve të Kosovës që jetojnë në vendbanime të largëta dhe të izoluar (enklava).

Pritjet nga regjistrimi i popullsisë

Parashikimet dhe pritjet e të anketuarve gjatë procesit të hulumtimit ndryshonin dukshëm në përmbajtje dhe në thelb. Më shpesh, rezultatet e mundshme të regjistrimit dhe pjesëmarrja eventuale e serbëve të Kosovës ishin të lidhura me perspektivat e kufizimit të të drejtave të garantuara për komunitetet joshumicë në Kosovë. Pritjet e të anketuarve nga regjistrimi u grupuan në disa qëndrime kyçe (jo domosdoshmërisht të rastësishme), p.sh. deklarata:

- Pjesëmarrja e ulët e serbëve të Kosovës do të ketë pasojë të drejtpërdrejtë cenimin e të drejtave të garantuara për këtë dhe komunitete tjera joshumicë në Kosovë.



Shpresoj se do të dëshmojmë se jemi më shumë sesa mendojmë se jemi dhe se kredibiliteti jonë në institucione do të rritet.

- PJESËMARRËS I GRUPIT TË FOKUSIT

- Në përgjithësi, pavarësisht nga skenarët e ndryshëm të mundshëm të inkurajuar nga (mos)pjesëmarrja e serbëve në regjistrimin e ardhshëm të popullsisë, çështja e jetës së përditshme të serbëve në Kosovë nuk do të ndryshojë në mënyrë dramatike. Sipas fjalëve të një prej pjesëmarrësve në fokus grup që jeton në enklavën në jug të lumit Ibër: "Të drejtat për shumë vite janë mohuar në masë të madhe, kështu që nuk kam frikë nga mohimi më i madh i të drejtave, sepse ato janë pothuajse inekzistente".
- Ekziston frika e mazhoritarizmit nga shqiptarët në zonat ku serbët janë pakicë dhe se procesi i regjistrimit nuk do të "keqpërdoret në kuptimin e paraqitjes së të dhënave joreale kur bëhet fjalë për komunitetin serb, në favor të shumicës shqiptare".
- Të rinjtë nuk janë veçanërisht të interesuar për rezultatet e regjistrimit për faktin se të rinjtë "në përgjithësi nuk pyeten për asgjë, kështu që në këtë kuptim, mendimet tona ose pritjet dhe parashikimet tona për regjistrimin janë krejtësisht të parëndësishme". Në këtë kuptim, shumica e të rinjve që morën pjesë në hulumtim nuk kishin pritshmëri të veçanta. Është theksuar në disa raste se pritjet janë të ndryshme e numrit të përgjithshëm të popullsisë së Kosovës dhe se "nëse ky numër është afër rezultateve të regjistrimit të mëparshëm apo edhe më i madh, do të konsideroj se regjistrimi është përdorur për qëllime politike, dhe se rezultatet janë të pasakta" (cituar nga fokus grupet e mbajtura në jug të Kosovës). Argumenti

kryesor në mbështetje të këtij pretendimi është fakti se prej dekadash ka një emigrim intensiv të qytetarëve nga Ballkani Perëndimor, veçanërisht të atyre që i përkasin brezave të rinj.

- Kur u diskutua për rregullsinë e regjistrimit të ardhshëm, shumica dërrmuese e të anketuarve u pajtuan se, nëse nuk vjen deri te një krizë politike dhe të sigurisë, dhe Beogradi "serbeve të Kosovës u jep dritën e gjelbër për pjesëmarrje në procesin e regjistrimit", i gjithë procesi do të kalojë pa pengesa dhe parregullsi të mëdha. Në kuadër të këtyre diskutimeve u theksua se në kushte të tilla më në fund do të mund të kuptohet numri i saktë i serbëve që jetojnë në Kosovë, gjë që në fund do të kontribuonte në "shpeshherë ankande dashakeqe me numra", tha një nga ekspertët e intervistuar.
- Ekspertët e intervistuar theksuan se presin një regjistrim adekuat (me kusht që ndërkohë të mos katalizohet ndonjë krizë e re), që sipas vlerësimeve të tyre, do të tregojë se në dekadën e fundit një numër i madh i pjesëtarëve të komunitetit serb është larguar nga Kosova. "Është paradoksale që më në fund shifrat përfundimtare do të tregojnë situatën objektive numerike, por edhe do të pasqyrojnë gjendjen e migrimit masiv të serbëve nga Kosova".
- Së fundi, sa i përket vetë pjesëmarrjes, pritshmëritë në mesin e të anketuarve ndryshonin, nga parashikimi i një bojkoti të plotë, ndarjet ndërmjet serbëve të Kosovës rreth kësaj çështjeje, deri te një përqindje maksimale e lartë e pjesëmarrjes së komunitetit në procesin e regjistrimit të popullsisë.

Vlerësimet e numrit të përgjithshëm aktual të serbëve në Kosovë

Edhe pse një pjesë e konsiderueshme e këtij publikimi i kushtohet cikleve të mëparshme të regjistrimit të popullsisë në Kosovë dhe vlerësimet rreth numrit të popullsisë nga institucionet përkatëse (në mungesë të mbledhjes adekuate të të dhënave), ekipi hulumtues e konsideroi të përshatshme që në mesin e serbëve të Kosovës të shqyrtojë vlerësimet dhe projeksionet individuale për numrin aktual të këtij komuniteti joshumicë. Sipas të anketuarve, numri i serbëve që jetojnë në Kosovë sillet si në vijim (duke filluar nga më i përmenduri deri tek ai më pak i përmenduri):

- 100,000 - 110,000 serbë të Kosovës,
- 90,000 - 95,000 serbë të Kosovës,
- 80,000 - 85,000 serbë të Kosovës,
- 120,000 - 130,000 serbë të Kosovës,
- 70,000 - 75,000 serbë të Kosovës,
- 200,000 serbë të Kosovës,
- 150,000 serbë të Kosovës.

Ata të anketuar që theksuan dallimin në mes të numrit të serbëve që i ndanë lumi Ibër në shumicë absolute deklaruan se më shumë pjesëtarë të këtij komuniteti jetojnë në jug të asaj vije ndarëse.



Sa i përket numrit të serbëve që jetojnë sot në Kosovë, është e vështirë të përcaktohet situata reale, sepse mendoj se është jo humane të ceken shifra dhe të merren parasysh vetëm ata që aktualisht jetojnë në Kosovë, e të mos përfshihen personat e zhvendosur që në Kosovë kanë pronë dhe që për shkak të rrethanave u detyruan të largohen nga vatrata e tyre.

- Pjesëmarrës i grupit të fokusit

Faktorë tjerë që përcaktojnë vendimin për pjesëmarrje në regjistrim

Krahas anketave dhe pyetjeve të sugjeruara nga faktorët që do të prodhonin pasoja praktike për karakterin dhe natyrën e regjistrimit, pjesëmarrësit në pjesën cilësore të hulumtimit në mënyrë të pavarur theksuan ato që i konsiderojnë si parakushte të rëndësishme për rregullsinë e procesit të regjistrimit. Të anketuarit, si elemente dhe faktorë më të rëndësishëm që do të mundësonin rregullsinë e këtij procesi veçuan:

- një klimë të shëndoshë politike që nuk do të bjerë viktimë e diskurseve nacionaliste (gjithnjë e më shumë) të dukshme në mesin e vendimmarrësve në Prishtinë dhe Beograd;
- pjesëmarrjen e serbëve të Kosovës në procesin e përgatitjes, monitorimit, regjistrimit dhe analizës së të dhënave të mbledhura;
- transparencën e punës së institucioneve, agjencive dhe organeve përkatëse që do të përfshihen drejtpërdrejt në zbatimin e regjistrimit të popullsisë;
- përfshirjen e serbëve të Kosovës në regjistrimin e bashkatdhetarëve për shkak të besimit dhe komunikimit në gjuhën e tyre amtare ("Nëse njerëzit nga komuniteti im janë regjistruar, do të ketë një dalje më të madhe");
- një fushatë publike intensive për të informuar qytetarët në gjuhën serbe për rëndësinë, procedurat dhe implikimet e refuzimit të pjesëmarrjes (veçanërisht gjodat e parashikuara);
- rolin aktiv të organizatave të shoqërisë civile që vijnë nga komuniteti serb, për të siguruar monitorim cilësor të zbatimit të të gjitha hapave në kuadër të procesit të mbledhjes së të dhënave;
- përkthim gramatikisht të saktë, të kuptueshëm dhe të lekturuar në serbisht të të gjitha materialeve gjatë gjithë kohëzgjatjes së procesit të regjistrimit (dhe, më e rëndësishmja - materialit të regjistrimit);

- trajnim të posaçëm të regjistruësve në fushën e digjitalizimit, të cilët rrjedhimisht do të pajisen me njohuri profesionale për t'u shpjeguar qytetarëve drejtë dhe thjeshtë risitë e praktikës së regjistrimit;
- organizimin e tubimeve në vende publike në zonat e banuara me pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës, që do t'u ofrojnë qytetarëve të gjitha informatat e nevojshme lidhur me procesin e regjistrimit, me fokus të veçantë te të moshuarit; dhe
- përfshirjen e Policisë së Kosovës në sigurimin e rregullsisë së zhvillimit të procesit të regjistrimit në zonat ku gjatë pandemisë është vërejtur rritje e incidenteve ndaj pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë.



Sa i përket numrit të serbëve që jetojnë sot në Kosovë, është e vështirë të përcaktohet situata reale, sepse mendoj se është jo humane të cekem shifra dhe të merren parasysh vetëm ata që aktualisht jetojnë në Kosovë, e të mos përfshihen personat e zhvendosur që në Kosovë kanë pronë dhe që për shkak të rrethanave u detyruan të largohen nga vatrat e tyre.

- AKTIVIST SOCIAL PËR SHUMË VITE

Rekomandime

Regjistrimi i popullsisë si një nga proceset më të rëndësishme statistikore dhe demografike, veçanërisht në demokracitë në tranzicion dhe shoqëritë pas konfliktit, është një faktor kyç në zhvillimin socio-ekonomik dhe politik të vendit. Në këtë kuptim, informimi dhe përfshirja e serbëve të Kosovës në regjistrimin e popullsisë së vitit 2022 do të prodhonte pasoja afatgjata (pozitive) për të gjithë shoqërinë dhe ekonominë në Kosovë. Në të njëjtën kohë, një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të dhënave demografike do të ekspozonte mangësitë që lidhen me tërësinë e kornizave juridike-institucionale, socio-ekonomike dhe politike në Kosovë. Gjithashtu, është e nevojshme të ndërmerren një sërë hapash konkretë që do të kontribuonin në informimin dhe pjesëmarrjen (ndoshta më domethënëse) të pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës në regjistrimin e ardhshëm. Bazuar në hulumtimin e sasiar dhe cilësor, dhe veçanërisht në sugjerimet dhe vërejtjet e ekspertëve të intervistuar në fushën e së drejtës, medias dhe politikës, janë ofruar një sërë rekomandimesh drejtuar qytetarëve, institucioneve, komunitetit ndërkombëtar dhe vendimmarrësve, ku:

- një fushatë informuese publike për regjistrim të popullsisë në gjuhën serbe, do të ofrojë informacion të detajuar dhe të kuptueshëm për rëndësinë dhe detajet e këtij procesi;
- një përcaktim më i qartë i shtrirjes së popullsisë së përcaktuar si rezidente;
- modalitetet e të drejtave të personave të zhvendosur për të marrë pjesë në procesin e regjistrimit, që në konsultim me përfaqësuesit e tyre, përcaktojnë kornizën dhe kushtet në të cilat këta persona, por edhe të kthyerit që nuk qëndrojnë në Kosovë në periudha të caktuara të vitit (veçanërisht gjatë muajve të dimrit), mund të marrin pjesë në regjistrim;
- mënyrat për regjistrimin dhe inventarizimin e paanshëm të pasurisë së pa uzurpuar dhe të uzurpuar të personave të zhvendosur;
- përkthimi adekuat i materialit shoqëruar rreth regjistrimit të popullsisë dhe përshtatja i regjistrimit të digjitalizuar për personat që nuk kanë njohuri digjitale;
- që përfaqësuesit e serbëve të Kosovës dhe organizatave joqeveritare nga ky komunitet të marrin pjesë aktive dhe të zgjidhen anëtarë të Komisionit Qendror dhe Komunal të Regjistrimit, si organe kyçe për monitorimin e rregullsisë së regjistrimit;
- mekanizmat minimalë të monitorimit nga komuniteti ndërkombëtar i cili nga ana e tij do të kontribuojë në mbledhjen e të dhënave që nuk do të jenë subjekt dyshimi dhe do të krijojnë hapësirë për spekulime;
- përfshirja e ekspertëve ligjorë nga komuniteti serb në miratimin e Ligjit të ri për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, duke ofruar përkthim (dhe lektorim) adekuat të dokumentit përfundimtar në gjuhën serbe;
- pamundësimi ligjor i përfshirjes së pronës private të uzurpuar në kategorinë me pasuri që nuk ka barrën e kontestit pronësor, por siguron kategorizimin dhe evidentimin e saj të veçantë (për sistemimin dhe zgjidhjen e mëtejshme të problemit të pronës së uzurpuar);
- distancimi i akterëve kyç politikë nga narrativët e krahut të djathtë, thellimi i distancës ndëretnike dhe presioni ndaj popullatës për t'u shprehur në mënyrën e tyre;
- deklarim i qartë dhe zyrtar i Beogradit nëse do të mbështesë, parandalojë apo lejojë serbët e Kosovës të vendosin vetë për të marrë pjesë në regjistrim.

Iniciativa Open është e përkrahur nga KFOS

